



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 78**

**13 maj**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Ligj nr. 128/2013 datë 25.4.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për ndërtimin e segmentit Qukës-Qafëploçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë-Korçë.....	3339
Ligj nr. 130/2013 datë 25.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.....	3367
Vendim i Kuvendit nr. 40/2013, datë 6.5.2013	Për disa ndryshime në vendimin e kuvendit nr. 93, datë 7.4.2011 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.....	3375

**LIGJ**  
**Nr. 128/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE TË MARRËVESHJES SË  
AGJENCISË ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR NDËRTIMIN E  
SEGMENTIT QUKËS - QAFËPLOÇË, SI PJESË E KORRIDORIT RRUGOR  
TIRANË - KORÇË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja Istisna'a dhe marrëveshja e Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për ndërtimin e segmentit Qukës - Qafëploçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë - Korçë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8146, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

Nr. i projektit: ALB-0107

**MARRËVESHJA ISTISNA'A**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS**  
**ISLAMIKE PËR ZHVILLIM NË LIDHJE ME NDËRTIMIN E SEKSIONIT QUKËS-QAFË**  
**PLLOÇË TË KORRIDORIT RRUGOR TIRANË-KORÇË**

**MARRËVESHJA ISTISNA'A**

Kjo Marrëveshje lidhet më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ H (që përputhet me \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si blerësi (këtu e më poshtë të quajtur "Përfituesi") dhe Bankës Islamike për Zhvillim si shitësi (këtu e më poshtë të quajtur "Banka").

Përfituesi dhe Banka, së bashku quhen "Palët" dhe individualisht "Pala".

Ndërsa:

A. Përfituesi i ka kërkuar Bankës të financojë ndërtimin e punimeve të përshkruara si seksioni i rrugës, i financuar nga IDB-ja në shtojcën I (këtu e më poshtë i quajtur si "Aseti") nëpërmjet Istisna'a për përdorim në ndërtimin e seksionit Qukës-Qafë Ploçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë, siç përshkruhet në shtojcën II (këtu e më poshtë të quajtur "Projekti");



B. Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës më 29.3.1434H (që përputhet me 10.2.2013G) ka aprovuar ndërtimin e Asetit për Projektin në një shumë që nuk kalon USD 125,000,000/- (njëqind e njëzet e pesë milionë dollarë amerikanë) (këtu e më poshtë e quajtur “shuma e aprovuar”).

C. Çmimi i shitjes do t’i paguhet nga Përfituesi Bankës në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet pas një periudhe realizimi prej 4 (katër) vjet. Këta terma dhe kushte i janë komunikuar dhe janë pranuar nga Përfituesi.

D. Raporti ndërmjet Bankës dhe Përfituesit është ai i shitësit dhe blerësit sipas parimeve të Shari’ah Islamik, siç interpretohet nga Islamic Fiqh Academy dhe shprehur në Standardet Shari’ah të publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI).

Kështu, Banka dhe Përfituesi bien dakord si më poshtë:

## Seksioni 1

### Përkufizime - interpretimi

1.1 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mposhtëm në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që është pranë tyre më poshtë:

“Marrëveshje Agjencie”, marrëveshja me të njëjtën datë ndërmjet Bankës dhe Përfituesit, ku Përfituesi do të veprojë si agent i Bankës në zgjedhjen e Kontraktorit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Asetit.

“Shuma e aprovuar”, shuma e specifikuar në paragrafin B më sipër.

“Aseti”, punët e përshkruara në seksionin rrugor të financuar nga IDB-ja në shtojcën I.

“Ditë pune”, çdo ditë në të cilën bankat janë zyrtarisht të hapura për punë në vendin ku është e pagueshme një shumë ose disa shuma nga Përfituesi Bankës në monedhën në të cilën do të bëhet kjo pagesë.

“Kostoja kapitale”, kostoja e përgjithshme e ndërtimit të Asetit që do të përfshijë çmimin e Kontratës dhe çdo kosto ose shpenzim tjetër të pësuar nga Banka në ose në lidhje me ndërtimin e Asetit plus një normë shtesë të ndryshueshme LIBOR 6-mujor USD plus 155 pikë bazë në vit të zbatueshëm për çdo disbursim gjatë periudhës së realizimit.

“Marrëveshja e konsulencës”, marrëveshja me Konsulentin për dhënien e shërbimeve të konsulencës që i përkasin Asetit.

“Konsulenti”, konsulenti, të cilit i besohet mbikëqyrja e Asetit që kryhet sipas Kontratës, siç tregohet në Marrëveshjen e Konsulencës.

“Kontrata”, kontrata(t) për ndërtimin e Asetit të lidhur në emër të Bankës nga Përfituesi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese me Kontraktorin(ët).

“Çmimi i kontratës”, çmimi i pagueshëm i Kontraktorit për ndërtimin e Asetit.

“Kontraktori”, Kontraktori(ët) që u besohet ndërtimi i Asetit.

“Disbursimi”, pagesa faktike e një pjese të shumës së aprovuar.

“Data e hyrjes në fuqi”, data në të cilën Banka e deklaron këtë Marrëveshje në fuqi në përputhje me seksionin 9.

“Raste të mosplotësimit të detyrimeve”, ndodhja e një ngjarjeje të parashikuar në seksionin 7.

“Agjencia Zbatuese”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

“Disbursimi i parë”, pagesa e parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me politikat dhe udhëzimet e Bankës.

“Periudha e realizimit”, periudha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe që përfundon 4 (katër) vjet më vonë: LIBOR i) në lidhje me çdo periudhë përkatëse prej një (1) muaji ose më 3340

shumë, norma e interesit për depozitat për një periudhë, që është numri i të gjithë muajve që përputhen më shumë me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

ii) në lidhje me një periudhë përkatëse më të vogël se një muaj, norma e interesit për depozitat në USD për një periudhë prej një (1) muaj (periudha për të cilën merret më poshtë quhet “periudhë përfaqësimi”), që caktohet nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe deklarohet nga Shërbimi i Monitorimit të Normave të Parasë Reuters ose një agjenci lajmesh financiare në orën 11:00, ora e Londrës, ose në një datë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në ditën (data e rivendosjes), që bie dy (2) ditë pune në Londër para ditës së para të periudhës përkatëse.

Nëse një normë e tillë nuk shpallet nga Reuters ose nga një agjenci tjetër e lajmeve financiare, Banka u kërkon zyrtarëve qendrorë në Londër të “Bankave të Referencës” të kuotojnë normën në të cilën ofrohen depozitat në USD në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre, afërsisht në orën 11:00 me orën e Londrës në datën e rivendosjes, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse jepen të paktën dy kuotime të tilla, norma do të jetë mesatarja matematikore e kuotimeve të dhëna.

Nëse jepen më pak se dy kuotime, siç kërkohen, furnitori i kërkon zyrës qendrore në New York City të Bankave të Referencës të kuotojnë normën në të cilën ofrohen depozitat në USD në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre, afërsisht në orën 11:00 me orën e New York City në ditën që bie dy (2) ditë pune në New York pas datës së rivendosjes, në bankat kryesore në tregun evropian për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse jepen të paktën dy kuotime të tilla, norma do të jetë mesatarja matematikore e kuotimeve të dhëna.

Për qëllimet e përkufizimit të mësipërm:

i) Ditë pune në Londër: Një ditë në të cilën bankat janë të hapura për aktivitet normal në Londër dhe ditë pune në New York, është një ditë kur bankat janë të hapura për aktivitet normal në New York City;

ii) Të gjitha përqindjet që rrjedhin nga çdo llogaritje, të përmendura në këtë përkufizim, do të rrumbullakohen, nëse është e nevojshme në pesë shifra dhjetore;

iii) Banka do të njoftojë përfituesin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka;

iv) “Bankat e Referencës”, zyrtarët qendrorë në Londër të JPMorgan Chase, Citibank N.A. dhe HSBC dhe/ose një bankë tjetër e caktuar nga Banka në vend të një nga bankat e mësipërme.

“Projekti” ka kuptimin e përshkruar në paragrafin A më sipër.

“Praktika të sanksionueshme”, çdo praktikë korruptive, praktikë e detyruar, praktikë e fshehtë, praktikë mashtruese ose praktikë penguese:

a) “Praktikë korruptive” është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale tjetër;

b) “Praktikë detyruese” është çdo veprim ose mosveprim cenimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, një Palë ose pasurinë e palës për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale;

c) “Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, e krijuar për të arritur një qëllim të parregullt, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të parregullt të veprimeve të një pale tjetër;

d) “Praktikë mashtruese” është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpriqet të çorientojë me dashje ose nga pakujdesia një palë për të përfutur një përfitim financiar ose tjetër, ose të mënjanojë një detyrim;

e) “Praktikë penguese” është:

i) prishja e qëllimshme, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provave të rëndësishme për hetimin ose bërja e deklarimeve të rreme para hetuesve, me qëllim që të pengohet në mënyrë të konsiderueshme hetimi i Bankës për akuzat e praktikës korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta; dhe/ose kërcënimi, ngacmimi ose trembja e një pale për ta penguar atë në deklarimin e njohurive të saj për çështjet e rëndësishme për hetimin ose në ndjekjen e hetimit; ose



ii) veprimet që synojnë të pengojnë në mënyrë të konsiderueshme marrjen nga Banka të informacionit të kërkuar nga kontrata në lidhje me hetimin e Bankës të akuzave për praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta.

“Çmimi i shitjes”, çmimi i Asetit që i paguhet nga Përfituesi Bankës në përputhje me seksionin 4.

“Norma SWAP”, norma që do të zgjidhet nga Banka në llogaritjen e çmimit të blerjes, një ditë pune para fundit të periudhës së realizimit, nga norma më e ulët e përftuar gjatë krahasimit:

a) normat e kuotuar nga dhe të përfuara nga institucionet që kanë marrëdhënie me SWAP të pranueshme për Bankën; dhe

b) normat e kuotuar në Bloomberg ose çdo agjenci tjetër lajmesh siguruese lajmesh financiare të pranueshme për Bankën.

Për hir të qartësisë, çdo normë që përftohet ose llogaritet do të jetë për një shkëmbim amortizues fiks-luhatës që ka NPV zero në fillim për të cilin:

i) monedha e të dyja anëve është në monedhën USD;

ii) të dyja anët kanë një maturim të barabartë me periudhën e shlyerjes;

iii) të dyja anët i nënshtrohen grafikut të miratuar të amortizimit të kostos së kapitalit;

iv) ana e fiksuar ka një pagesë interesi shtesë me shpeshtësi gjysmëvjetore dhe bazë llogaritjeje 30/360 ditë;

v) ana luhatëse ka një pagesë kupon prej 6 muaj USD Libor (d.m.th., me shpeshtësi gjysmëvjetore dhe bazë llogaritje faktike/360 ditë);

të dyja anët përdorin kurbat e këmbimit, që janë të disponueshme në Bloomberg (menaxheri i këmbimit - SWPM) për qëllimet e çmimeve. Në këtë rast, norma e këmbimit do të jetë kuponi i anës fikse.

“Taksat”, çdo taksë, detyrim, tarifë apo pagesë me natyrë të ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo gjore që paguhet në lidhje me një mospagesë ose vonesë në këtë pagesë).

“Dollari amerikan/USD”, monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

#### 1.2 Interpretim:

i) një “shtojcë”, “grafik”, përveç kur tregohet ndryshe, do të interpretohet si referencë ndaj një shtojce, grafiku të marrëveshjes ose dokumenti në të cilin paraqitet një referencë e tillë;

ii) “duke përfshirë” do të interpretohet si një referencë ndaj “duke përfshirë, pa kufizim”;

iii) një “ligj” do të interpretohet si çdo akt ligjor (duke përfshirë ligjin e kodifikuar dhe zakonor), statut, kushtetutë, dekret, vendim, traktat, rregullore, direktivë, akt nënligjor, akt administrativ ose një masë tjetër legjislative e një qeverie përkatëse, suprakombëtare, qeverisje lokale, organi rregullator ose ligjor apo gjykate;

iv) të gjitha referencat ndaj çdo marrëveshjeje (duke përfshirë, pa kufizim, këtë Marrëveshje) apo dokumenti, përfshijnë një referencë ndaj asaj marrëveshjeje apo dokumenti të ndryshuar, plotësuar, zëvendësuar, rinovuar ose caktuar;

v) “nen”, “seksion”, “paragraf” ose “preambulë”, përveç kur përcaktohet ndryshe, do të interpretohet si i kësaj ose për këtë Marrëveshje;

vi) “titujt në këtë Marrëveshje” janë vetëm për lehtësi dhe nuk kanë si synim e nuk do të interpretohen për të ndryshuar, kufizuar apo zgjeruar në ndonjë mënyrë objektin ose kuptimin e gjuhës së përdorur në këtë Marrëveshje;

vii) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjellas; dhe

viii) një “ditë” dhe “vit” është një ditë, muaj dhe vit, përkatësisht i kalendarit gregorian;

ix) fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Agjencisë dhe që nuk përkufizohen këtu kanë të njëjtin kuptim si në Marrëveshjen e Agjencisë.

## Seksioni 2

### **Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit**

2.1 Banka bie dakord që Aseti të ndërtohet në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Përfituesi bie dakord të marrë në dorëzim Asetin sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe të paguajë çmimin e shitjes.

2.2 Për mënjanimin e çdo dyshimi, Përfituesi bie dakord që Banka të realizojë ndërtimin e Asetit nga Kontraktori që do të zgjidhet në përputhje me dispozitat përkatëse të treguara në Marrëveshjen e Agjencisë.

2.3 Në përputhje me seksionet 3 dhe 6, ndërtimi i Asetit do të përfundojë brenda 4 (katër) vjetëve nga data e disbursimit të parë.

2.4 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, do të ofrojë të gjithë mundësinë e arsyeshme për përfaqësuesit e akredituar të Bankës, të bëjnë vizita për qëllime në lidhje me Asetin dhe të inspektojnë Projektin, Asetin dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës, dhe do t'i japë Bankës të gjithë atë informacion që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimet e shumës së aprovuar, Projektin, Asetin dhe operacionet dhe gjendjen financiare të Agjencisë Zbatuese gjatë zbatimit të Projektit dhe deri sa të jenë bërë të gjitha pagesat nga Përfituesi plotësisht.

2.5 Përfituesi do të përmirësojë dispozitat e kontratës së punimeve civile për segmentin rrugor prej 2.9 km fillestarë, me qëllim që të realizohet i njëjti nivel sigurie dhe pajisjet e tjera të autostradës sipas parashikimit në segmentin rrugor të Projektit.

## Seksioni 3

### **Pranimi dhe statusi i Asetit**

3.1 Përfituesi do të udhëzojë Agjencinë Zbatuese të pranojë në mënyrë të pakthyeshme Asetin për të gjitha qëllimet e saj, kur Agjencia e Zbatimit të nënshkruajë certifikatën përfundimtare të pranimit.

3.2 Gjendja e Asetit: Pa cenuar sa më sipër, Banka nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ose detyrim çfarëdo kundrejt Përfituesit ose një personi apo subjekti tjetër, në lidhje me:

a) ndonjë detyrim, humbje apo dëm të shkaktuar (apo që pretendohet se është shkaktuar) drejtpërdrejt ose jo nga Aseti, ose nga një parregullsi e tij, ose mangësi apo defekt në të ose nga rrethana të tjera në lidhje me të;

b) në lidhje me përdorimin ose operimin e Asetit, ose ndonjë rrezik në lidhje me të;

c) ndonjë ndërprerje shërbimi, humbje aktiviteti apo fitimi të pritur apo dëme pasuese.

3.3 Banka merr përsipër t'i kalojë Përfituesit çdo përfitim nga ndonjë garanci, kusht apo garanci në lidhje me Asetin që mund t'i jetë dhënë nga Kontraktori Bankës dhe që është shqyrtuar dhe pranuar nga Përfituesi dhe të gjitha kushtet dhe garancitë e tjera, që mund të jenë parashikuar me ligj ose njohur sipas zakonisht në favor të Bankës. Përveç kësaj, Banka do të marrë çdo masë tjetër që Përfituesi do t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për t'i dhënë mundësi Përfituesit të ngrejë pretendime kundrejt Kontraktorit.

3.4 Pronësia dhe rreziku: Titulli dhe rreziku i Asetit do t'i kalojnë Përfituesit pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit.

3.5 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, do të sigurojë të gjithë mirëmbajtjen rutinë, periodike dhe të veçantë të nevojshme për Asetin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara/me defekt ose pjesët e Asetit dhe ta mbajë Asetin në një gjendje normale dhe të mirë operacionale gjatë jetëgjatësisë së tij.



#### Seksioni 4 Pagesa e çmimit të shitjes

4.1 Çmimi i shitjes është US\$ 170,315,334.49 (njëqind e shtatëdhjetë milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e katër pikë dyzet e nëntë dollarë amerikanë).

4.2 i) Çmimi i shitjes do të llogaritet në fund të periudhës së realizimit, bazuar në koston e kapitalit plus një shtesë të normës Swap LIBOR 6-mujor në USD, mbizotëruese në atë kohë, që korrespondon me periudhën e amortizimit të kapitalit plus 155 pikë bazë për vit.

ii) Kostoja e kapitalit do të përcaktohet duke u bazuar në disbursimet totale në fund të periudhës së realizimit, ose kohës së shitjes, plus një normë shtesë të ndryshueshme LIBOR 6-mujor USD plus 155 pikë bazë.

4.3 Përfituesi do ta paguajë çmimin e shitjes në 30 (tridhjetë) këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme gjysmëvjetore, i pari prej të cilëve bëhet i pagueshëm dhe i kërkueshëm gjashtë muaj nga fundi i periudhës së realizimit. Banka do t'ia dërgojë grafikun e pagesës së çmimit të shitjes Përfituesit menjëherë para lëshimit të certifikatës së pranimit përfundimtar.

4.4 Duke iu nënshtruar seksionit 4.6 dhe 4.7, çdo pagesë që i bëhet Bankës nga Përfituesi, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet në çdo monedhë të konvertueshme të pranueshme për Bankën për vlerën në datën e kërkueshme në llogarinë e Bankës ose në një mënyrë tjetër që Banka mund të njoftojë herë pas here me shkrim Përfituesin.

4.5 Çdo pagesë e kërkueshme do të konsiderohet të jetë bërë rregullisht kur ndonjë prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës marrjen e këtyre pagesave në llogarinë e Bankës tek ajo:

<b>Në dollarë amerikanë:</b>	<b>Në sterlina:</b>	<b>Në euro:</b>
A/c No:	A/c No:	A/c No:
GB36SINT60928000159111	GB13SINT60928000159137	FR7643899000019696500151088
Gulf International Bank	Gulf International Bank	Union De Banques Arabes Et
(UK) Ltd, One	(UK) Ltd, One	Françaises (UBAF)
Knightsbridge	Knightsbridge	92523 Paris, Neuilly Cedex
London SW1X 7XS	London SW1X 7XS	France
United Kingdom	United Kingdom	Télex No. 610334 UBAF
Telex No. 8812261/2	Telex No. 8812261/2	Swift Code: UBAFRPPXXX
Swift Code: SINTGB2L	Swift Code: SINTGB2L	

4.6 Nëse ndonjë pagesë bëhet e kërkueshme në një ditë që nuk është ditë pune, pagesa bëhet në ditën pasuese të punës.

4.7 Të gjitha pagesat e bëra nga Përfituesi, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të lira dhe pa zbritje të ose për llogari të taksave, kompensimit, kundërpretendimit ose një çështjeje tjetër. Nëse Përfituesit i kërkohet me ligj të bëjë një zbritje ose ndalim nga një shumë e pagueshme, shuma e pagueshme prej tij në lidhje me të cilën do të bëhet kjo zbritje ose ndalim, duhet të shtohet në masën e nevojshme për të siguruar që mbas kryerjes së zbritjes ose ndalimit, Banka të marrë dhe të mbajë (të lirë nga çdo detyrim në lidhje me çdo zbritje apo ndalim) një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë dhe mbajtur sikur të mos ishte bërë një zbritje apo ndalim i tillë.

4.8 Nëse Përfituesi nuk bën pagesën e një shume të pagueshme kur bëhet e kërkueshme, Përfituesi do të:

i) në përputhje me Parimet e Shari'ah Islamik, kompenson Bankën për çdo humbje, dëm, kosto dhe shpenzim faktik të arsyeshëm, që është dokumentuar rregullisht (duke përfshirë, pa u kufizuar në koston dhe shpenzimet ligjore dhe të agjentit), që pëson Banka si rezultat i vonesës së pagesës ndaj Bankës;

ii) paguajë Bankës një tarifë për pagesë të vonuar në lidhje me shumën e mbetur, e cila do llogaritet dhe zbatohet si një shumë e përcaktuar nga Banka pas zbatimit të formulës të treguar më poshtë:

$\frac{A \times B \times C}{360}$  Ku: "A" është shuma e papaguar;  
"B" është 01% në vit; dhe  
("C" është numri i ditëve nga dhe duke përfshirë këtë datë të kërkueshme për, dhe, duke përfshirë datën e pagesës faktike (para ose pas vendimit).

Banka, pas zbritjes së të gjitha kostove aktuale dhe shpenzimeve të shkaktuara, do të paguajë çdo shumë të marrë në përputhje me këtë seksion në llogarinë e Bankës Waqf Fund.

Nr. i llogarisë:	0000 100 102
Emri i Bankës:	The British Arab Commercial Bank
SWIFT Code:	BACMGB2L
IBAN:	GB69 BACM 4051 3200 100 102

## Seksioni 5

### Pezullimi, anulimi dhe përfundimi

5.1 Nëse brenda 180 (një qind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi, Kontrata nuk nënshkruhet apo Përfituesi nuk ka kërkuar disbursimin e parë, Banka, duke njoftuar Përfituesin, mund të anulojë shumën e aprovuar, përveç kur është e pranon justifikimin e Përfituesit për këtë vonesë.

5.2 Përfituesi mund t'i kërkojë Bankës t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje dhe të anulojë shumën e aprovuar ose një pjesë të saj në çdo kohë para nënshkrimit të Kontratës.

5.3 Në çdo kohë që Banka vendos, pas konsultimit me Përfituesin, që një pjesë e shumës së aprovuar nuk do të jetë e nevojshme për të financuar Projektin, Banka mund të njoftojë Përfituesin për shfuqizimin e detyrimit të Bankës për të disbursuar këtë pjesë. Kjo pjesë e shumës së aprovuar do të konsiderohet e anuluar me dorëzimin e këtij njoftimi.

5.4 Pas pagesës së bërë, Bankës të të gjitha shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshjeje do të përfundojë dhe detyrimet e palëve sipas saj mbarojnë.

5.5 Banka, me njoftim drejtuar Përfituesit, mund të pezullojë ose të anulojë shumën e aprovuar ose një pjesë të saj në një prej rasteve të mëposhtme:

a) Ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila:

i) sipas mendimit të Bankës do ta bëjë të pamundur që Përfituesi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) do të pengojë arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo Marrëveshjeje.

b) Një përfaqësim i bërë nga Përfituesi ose një deklaram i dhënë dhe që duhet të merrej për bazë nga Banka në përpunimin e Projektit për aprovimin ose për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, ka qenë i paplotë ose i pasaktë në një aspekt material.

c) Banka përcakton se:

i) Përfituesi është në shkelje të një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) në lidhje me prokurimin e ekzekutimit të çdo kontrate që duhet të financohet plotësisht ose pjesërisht nga shumat e financimit, nëse një person ose subjekt është përfshirë në ndonjë praktikë të sanksionueshme dhe Përfituesi nuk ka marrë masa të përshtatshme dhe në kohë, të pranueshme për Bankën, për të korrigjuar situatën ose për t'i zgjidhur këto praktika kur ato ndodhin.

d) Përfituesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij për të paguar një shumë që kërkohet nga Banka (ose çdo organ i anëtarësuar me Bankën).

5.6 Nëse ndonjë prej ngjarjeve të specifikuar në paragrafët (a) deri në (d) të nenit 8.5 ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, pastaj në çdo kohë të mëvonshme gjatë vazhdimit të ngjarjes, Banka mundet, duke njoftuar Përfituesin, ta ndërpresë Kontratën.

5.7 Çdo pezullim i shumës së aprovuar do të vazhdojë derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë shkaktuar pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Banka të ketë njoftuar Përfituesin që





angazhimi i Bankës për të ndërtuar Asetin është rivendosur, cilado të ndodhë më parë; megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi të tillë rivendosjeje, angazhimi për të ndërtuar Asetin do të rivendoset vetëm në masën dhe në përputhje me kushtet e specifikuar në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk ndikon ose cenon ndonjë të drejtë, tagër apo mjet mbrojtës të Bankës në lidhje me një ngjarje tjetër ose pasuese të përshkruar në këtë seksion.

5.8 Në rast se Kontraktori nuk përmbush një prej detyrimeve të tij sipas Kontratës dhe Përfituesi, në konsultim me Bankën, e përfundon Kontratën në përputhje me kushtet e saj, ky përfundim pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga kjo zgjidhje do të ketë efektin e anulimit të çdo shume të mbetur të padisbursuar nga shuma e aprovuar, përveç kur Banka bie dakord ndryshe. Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, Përfituesi do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të ndihmojë Bankën në përfundimin nga Kontraktori të atyre shumave të çmimit të Kontratës dhe çdo shume tjetër që mund të jetë disbursuar nga Banka para përfundimit të Kontratës.

5.9 Anulimi i shumës së aprovuar ose një pjese të saj nuk do të ketë ndikim në angazhimet e bëra, detyrimet e marra përsipër apo të drejtat e lindura para datës së anulimit.

5.10 Përveç kur disbursimi është bërë nga shuma e aprovuar, nëse shuma e aprovuar anulohet në përputhje me këtë seksion, Marrëveshja do të konsiderohet automatikisht e përfunduar.

5.11 Me anulimin e shumës së aprovuar ose një pjese të saj dhe/ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje për shkak të një rasti të mosplotësimit të detyrimeve ose të shkeljes nga Përfituesi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose mospagimit të dorëzimit të Asetit, Përfituesi do ta zhdëmtojë Bankën me një shumë të barabartë me koston kapitale dhe angazhimin e përcaktuar ose të pësuar në datën e përfundimit.

5.12 Pjesa e padisbursuar e shumës së aprovuar do të anulohet automatikisht në rastin e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje ose të Marrëveshjes së Agjencisë.

## Seksioni 6 Përfaqësime

Përfituesi përfaqëson që:

i) të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet të çdo lloji të nevojshme për të autorizuar ose që kërkohen për vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje kundrejt Republikës së Shqipërisë, janë siguruar ose kryer dhe janë të vlefshme dhe në fuqi të plotë;

ii) sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje, pretendimet e Bankës kundrejt Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje do të renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për çdo qenie në borxh të Përfituesit; dhe

iii) departamenti ose njësia përkatëse e ngarkuar me shërbimin e borxhit të jashtëm është instruktuar për të bërë pagesa nga këstet e çmimit të shitjes në datat e kërkueshme.

## Seksioni 7 Raste të mosplotësimit të detyrimeve

7.1 Nëse ka ndodhur një nga ngjarjet e specifikuar në këtë seksion dhe nuk ndërpritet, Banka me njoftim drejtuar Përfituesit, mund të deklarojë që i gjithi ose një pjesë e çmimit të shitjes do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm, dhe ky bëhet i tillë (pavarësisht parashikimeve në këtë Marrëveshje) pa ndonjë njoftim të mëtejshëm:

a) ka mungesë të pagesës së ndonjë kësti të çmimit të shitjes dhe ky mosplotësim detyrimi vazhdon për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh;

b) një mungesë, e ndryshme nga mungesa e specifikuar në seksionin 10.1(a), ka ndodhur në përmbushjen e ndonjë detyrimi të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo mungesë e tillë ka vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh;

c) një përfaqësim apo garanci e konfirmuar apo e bërë nga Përfituesi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje, ose në lidhje me ndonjë kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të gjendet të ketë qenë e pasaktë në aspektin material dhe do të vazhdojë të jetë e pasaktë për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit të dhënë për këtë Përfituesit nga Banka;

d) Përfituesi nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e tij kur bëhen të kërkueshme apo nuk do të jetë i aftë për të paguar; ose ndonjë kreditor do t'i ketë marrë posedimin ligjërisht apo do të jetë emëruar një administrator për të gjithë ose një pjesë të detyrimeve ose asetëve të Përfituesit; ose një masë zbatuese apo ekzekutive (ose proces i ngjashëm) do të jetë zbatuar apo është vendosur për sendet pasurore të Përfituesit dhe kjo masë zbatuese ose ekzekutim nuk do të jetë hequr për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë; ose do të jetë nxjerrë një urdhër apo do të jetë miratuar një rezolutë apo procedurë tjetër e ngjashme për likuidimin, falimentimin ose shkrirjen e Përfituesit; ose do të ketë ndodhur një ngjarje tjetër që sipas ligjit të zbatueshëm do të ketë efekt analog si ato të ngjarjeve të renditura më sipër në këtë paragraf;

e) ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e paekzekutueshme.

7.2 Nëse ka ndodhur ndonjë rast i mosplotësimit të detyrimeve ose ndonjë ngjarje, e cila në bazë të parashikimit ose njoftimit dhe parashkrimit, do të bëhej një rast i mosplotësimit të detyrimeve, Përfituesi do të njoftojë menjëherë Bankën për këtë me faks, duke përcaktuar natyrën e këtij rasti të mosplotësimit të detyrimeve ose ndonjë ngjarje tjetër dhe secilin prej hapave që Përfituesi po ndërmerret për ta korrigjuar atë.

7.3 Asnjë mënyrë veprimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte, tagri apo mjeti që i takon Bankës në rastin e një mosplotësi detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo marrëveshjeje tjetër, nuk do ta cenojë këtë të drejtë, tagër apo mjet dhe nuk do të interpretohet sikur hiqet dorë prej saj apo sikur kjo tolerohet; asnjë veprim i Bankës në lidhje me këtë qenie në vonesë apo tolerim të saj nuk cenon apo dëmton ndonjë të drejtë, tagër apo mjet të Bankës në lidhje me çdo rast mosplotësi të detyrimeve.

## Seksioni 8 Zhdëmtimi

8.1 Përfituesi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje merr përsipër të zhdëmtojë Bankën, në bazë neto pa tatime (me normat e zbatueshme të tatimeve lokale dhe të huaja) kundrejt, dhe bie dakord të mbrojë e ta mbajë të padëmtuar Bankën nga të gjitha detyrimet, tarifatat, humbjet, dëmet, gjobat, kërkesat, paditë, vendimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifatat dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore (duke përfshirë ato tarifata dhe shpenzime ligjore, që shkaktohen në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje), të çdo lloji dhe natyre, sido që të jenë vendosur, pësuar nga apo ngarkuar Bankës që rrjedh nga:

a) pronësia, posedimi, përdorimi, dokumentimi, heqja, kthimi ose aplikime apo disponime të tjera sipas Kontratës ose Marrëveshjes së Konsulencës, duke përfshirë ato që rrjedhin nga:

i) ndonjë humbje ose dëmtim i ndonjë prone apo vdekje apo dëmtim i ndonjë personi;

ii) patentat apo defektet e fshehura në Aset;

iii) çdo pretendim që bazohet në detyrim nga një veprim i paligjshëm apo tjetër;

iv) çdo pretendim bazuar në një shkelje të një patente, marke tregtare ose të drejte autori;

v) çdo pretendim i bazuar në detyrime që rrjedhin nga ligjet e zbatueshme mjedisore ose aprovimet mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me titullin e Asetit ose tokën në të cilën është ndërtuar;

vii) çdo pretendim ose mosmarrëveshje në lidhje me Kontratën ose çdo letër kredie të vendosur sipas ose në lidhje me Marrëveshjen e Konsulencës;



b) ndodhinë e ndonjë mosplotësimi, detyrimi ose ndonjë mospërbushje tjetër nga ana e Përfituesit ose Kontraktorit për të përmbushur ose respektuar ndonjë term të kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur në lidhje me të apo përndryshe në lidhje me Asetin, por duke përjashtuar çdo pretendim të bazuar në një mosveprim nga ana e Bankës për të respektuar detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë dokumenti, marrëveshjeje apo kontrate të lidhur nga Banka në lidhje me të ose përndryshe në lidhje me Asetin;

c) çdo pretendim, rëndim, mjet sigurie padie, peng ose proces gjyqësor në lidhje me titullin e ose interesin në Aset ose tokën ku ai është ndërtuar.

8.2 Përfituesi do t'i bëjë Bankës njoftim të menjëhershëm për çdo ndodhi apo kusht në dijeni të Përfituesit si pasojë e të cilit Banka është ose mund të ketë të drejtën të zhdëmtohet. Zhdëmtimi i parashikuar në seksionin 8.1 do të zbatohet specifikisht dhe do të përfshijë pretendimet dhe paditë e ngritura nga ose në emër të punonjësve të Përfituesit dhe Përfituesi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje heq dorë shprehimisht, kundrejt Bankës, nga çdo imunitet ndaj të cilit përndryshe Përfituesi do të kishte të drejtë sipas ligjeve të zbatueshme. Përfituesi, me kërkesë të Bankës (por në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga kjo kërkesë) do të rimbursojë menjëherë Bankën për shumat e shpenzuara në lidhje me sa më sipër ose pagesën e këtyre shumave drejtpërdrejt. Përfituesit do t'i kalojnë të drejtat e Bankës për çdo çështje në lidhje me të cilat Përfituesi ka rimbursuar Bankën për shumat e shpenzuara prej tij ose që i ka paguar faktikisht këto shuma drejtpërdrejt në përputhje me seksionin 8.1. Në rast se kundër Bankës është ngritur ndonjë padi apo ka filluar ndonjë gjykim në lidhje me ndonjë pretendim për zhdëmtim, Banka, pas marrjes së njoftimit të fillimit të këtij gjykimi apo padie, do të njoftojë për këtë Përfituesin, duke përfshirë një kopje të të gjitha dokumenteve që i janë dërguar Bankës. Përfituesi, me kërkesën e Bankës, mund të kundërshtojë ose të mbrojë këtë padi ose gjykim me shpenzimet e Përfituesit, ose të marrë masa për kundërshtimin ose mbrojtjen me një këshilltar të zgjedhur nga Përfituesi, që është normalisht i pranueshëm për Bankën. Në rastin e moskryerjes së kësaj nga Përfituesi, Përfituesi do të paguajë të gjitha shpenzimet dhe kostot (duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit), që pësohen nga Banka në lidhje me këtë padi ose gjykim.

## Seksioni 9 Efektiviteti

9.1 Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi nëse dhe derisa Përfituesi t'i paraqesë Bankës dokumentet e mëposhtme:

i) Prova të pranueshme për Bankën, që të tregojnë se nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Përfituesit është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga Republika e Shqipërisë;

ii) Opinion ligjor të pranueshëm për Bankën, të dhënë nga Ministri i Drejtësisë së Përfituesit, që përcakton se termat dhe kushtet e Marrëveshjes përbëjnë detyrime të ekzekutueshme dhe detyruese për Republikën e Shqipërisë në thelb në formën e parashikuar në shtojcën III të kësaj Marrëveshjeje;

iii) Një letër autorizimi që lëshohet nga Ministri i Financave ose një organ tjetër i autorizuar rregullisht i Përfituesit për Bankën Qendrore ose subjektin që kryhen funksionet e një Banke Qendrore që e udhëzon Bankën Qendrore se pagesat nga Përfituesi sipas kësaj Marrëveshjeje të kësteve të huas do të kryhen nga Banka Qendrore ose subjekti që kryhen funksionet e Bankës Qendrore në datat në të cilat ato bëhen të kërkueshme. Një kopje të letrës së autorizimit së bashku me një njohje nga Banka Qendrore ose subjekti që përmbush funksionet e Bankës Qendrore, që tregon se ajo e ka marrë letrën e autorizimit dhe që ajo do të respektojë udhëzimet që gjenden atje, do t'i paraqitet Bankës nga Përfituesi;

iv) Prova të pranueshme për Bankën, që tregojnë se toka për Projektin është e lirë nga të gjitha llojet e barrëve dhe se Përfituesi ka titull të ligjshëm dhe të vlefshëm të tokës; dhe

v) Të gjitha kushtet paraprake për të drejtën e Përfituesit për të përfutur fondet sipas një financimi tjetër janë përmbushur.

9.2 Nëse Marrëveshja nuk hyn në fuqi brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e Palëve do të përfundojnë, përveç kur Banka, pas shqyrtimit të shkaqeve të vonësës, do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Banka do të informojë menjëherë Përfituesin për këtë datë të mëvonshme ose përfundimin e Marrëveshjes, sipas rastit.

#### Seksioni 10 **Heqja dorë**

Mosushtrimi ose mostheksimi nga Banka i të drejtave të saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, ose vonesa e saj për këto apo mosushtrimi apo mostheksimi i ndonjë mjeti që ajo mund të ketë ndaj Përfituesit ose ndonjë vonesë për këtë, nuk do ta cenojë këtë të drejtë ose mjet dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet.

#### Seksioni 11 **Ligji i zbatuar - zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

11.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Shari'ah Islamik, siç janë shprehur në Islamic Fiqh Academy, siç shprehen në Standardet e Shari'ah të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI) dhe siç interpretohet nga Komiteti Shari'ah i Bankës.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim i një Pale drejtuar Palës tjetër, që rrjedh nga kjo Marrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje ndërmjet Palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i një Palë drejtuar tjetrës, i paraqitet një paneli arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyruet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Islamike Ndërkombëtare për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s do të zbatohen në mungesë të një procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë pretendimi nga një Palë kundrejt tjetrës. Gjuha angleze do të përdoret gjatë gjithë procedurës së gjykimit në arbitrazh.

11.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi kopje të zbardhura të vendimit t'u jenë dhënë Palëve, vendimi nuk zbatohet, çdo Palë mund të kërkojë urdhër ekzekutimi, ose të fillojë një procedurë për të ekzekutuar vendimin, në çdo gjykatë me juridiksion kompetent ndaj palës tjetër, mund të zbatojë këtë vendim me ekzekutim të detyruar ose mund të ndjekë një mjet tjetër kundrejt palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

11.4 Çdo Palë në këtë Marrëveshje bie dakord që çdo vendim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje kundrejt saj mund të ekzekutohet ndaj fondeve të saj (aseteve) në çdo juridiksion. Palët në këtë Marrëveshje heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që ato mund të kenë për një padi, veprim apo gjykim, që rrjedh nga ose në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse përcillet në një juridiksion ku ajo ka fonde (asete) dhe nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim që një padi, veprim apo gjykim i tillë, i sjellë në një juridiksion të caktuar, është ngritur në një forum të papërshtatshëm.

11.5 Në masën që një Palë në këtë Marrëveshje mund të pretendojë në një juridiksion për vete ose asetet e saj imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi (paraparak apo si ekzekutim, para një vendimi arbitrazhi apo gjyqësor ose ndryshe) apo nga një proces gjyqësor tjetër ose në masën që në një juridiksion të tillë mund t'i vishet asaj vetë ose asetëve të saj ky imunitet (i pretenduar apo jo), kjo Palë bie dakord në mënyrë të pakthyeshme për të mos e pretenduar dhe në këtë mënyrë heq dorë nga ky imunitet.



## Seksioni 12 Bashkërendimi dhe njoftimet

12.1 Bashkërendimi. Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë si përfaqësuesi i autorizuar i Përfituesit (Përfaqësuesi i Përfituesit) do të përfaqësojë Përfituesin për të gjitha çështjet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të gjitha qëllimet dhe synimet pa kufizim, përkatësisht:

i) të mbajë marrëdhëniet me Bankën dhe të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve, që i takojnë Përfituesit në saxe të kësaj Marrëveshjeje;

ii) të gjitha komunikimet e çdo lloji, që i jepen nga Banka Përfaqësuesit të Përfituesit, do të konsiderohen t'i jenë dhënë rregullisht Përfituesit;

iii) të gjitha komunikimet e marra prej Bankës nga Përfaqësuesi i Përfituesit do të konsiderohen të jenë dhënë ose bërë rregullisht nga dhe të marra nga Përfituesi; dhe

vi) Përfaqësuesi i Përfituesit do të kryejë në çdo kohë bashkërendim dhe bashkëpunim të efektshëm dhe të rregullt, dhe do të garantojë që Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të kryejnë rregullisht detyrat e tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

12.2 Njoftimet. Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër që jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me të, bëhet me shkrim dhe konsiderohet të jetë dhënë rregullisht nëse jepet dorazi, me postë ajrore, me shërbim korrieri ose faks, drejtuar Palës që i adresohet në atë adresë të Palës që specifikohet më poshtë ose në një adresë tjetër që kjo palë ka përcaktuar, duke i bërë njoftim palës që i bën këtë njoftim, kërkesë apo komunikim.

Për Përfituesin:  
Ministria e Financave  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1  
Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: +355 4 22 28 405  
Fax: +355 4 22 58 494  
E-mail: sekretariazv1@minfin.gov.al  
Për Agjencinë Zbatuese:  
Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Ministria e Punëve Publike  
dhe Transportit  
Rruga "Sami Frashri", nr. 33  
Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: +355 4 22 34 702  
Fax: +355 4 22 23 600

Për Bankën:  
P.O. Box 5925  
Jeddah-21432  
Kingdom of Saudi Arabia  
Tel: +966 2 6361400  
Fax: +966 2 6366871  
Email: [archives@isdb.org](mailto:archives@isdb.org)

## Seksioni 13 Të ndryshme

13.1 Paragrafët dhe shtojcat përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

13.2 Autoriteti: Personi që nënshkruan këtë Marrëveshje në emër të cilësdo Pale që përfaqëson dhe garanton Palën tjetër që ai ose ajo ka tagrin dhe autoritetin e kërkuar ligjor për të nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Palës dhe ua nënshtron Palën detyrimeve të saj.

13.3 Tërësia e Marrëveshjes: Kjo Marrëveshje është marrëveshja e plotë dhe mbizotëron mbi çdo marrëveshje ose komunikim me shkrim apo me gojë ndërmjet Palëve në lidhje me këtë objekt.

13.4 Ndryshime: Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve.

13.5 Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave të

Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit, nuk do të kërkojnë aprovimin paraprak të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

13.6 Data e Marrëveshjes. Data e kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të jetë ajo që shfaqet në preambulë.

(FUNDI I NENEVE)

Faqja e nënshkrimit

Në dëshmi të kësaj, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në lidhje me ndërtimin e seksionit Qukës-Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë për një shumë që nuk kalon 125.000.000 USD (njëqind e njëzet e pesë milionë dollarë amerikanë) në datën e shkruar më sipër. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, ku secila palë merr një kopje të nënshkruar rregullisht të saj.

PËR DHE NË EMËR TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Emri:

Titulli:

PËR DHE NË EMËR TË  
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Emri:

Titulli:

SHTOJCA I  
PËRSHKRIMI I ASETIT

Projekti gjendet në korridorin e transportit Lindje-Perëndim të Shqipërisë. Projekti synon ndërtimin e një rruge 40.5 km të gjatë me dy korsi, që përfshin një tunel 375 m të gjatë me dy kalime ndërmjet Qukësit dhe Qafë-Plloçës. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e projektit është 152.75 milionë USD. Ajo përbëhet nga 42% kosto për punimet në rrugë, 23% për ura dhe viadukte, 23% për muret mbajtëse dhe 7% për tunelin.


1. Seksioni i financuar nga IDB-ja është 30.9 km i gjatë dhe ka një tunel të gjatë 375 m me dy kalime. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 m të gjera (7.3 metra mbulimi me asfalt), 2 bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe 2 bankina të paasfaltuara me gjerësi 1 m secila. Projekti do të përmirësojë 8 km ekzistues fillestarë dhe rreth 32.5 km gjatësi do të jetë ndërtimi i ri. Kostoja e vlerësuar e seksionit të financuar nga IDB-ja është 125.0 milionë USD.

2. Objekti i përgjithshëm i punimeve civile prej 40.5 km rrugë me dy kalime do të përfshijë:

- Gjatësia e rrugës	:	40.5 km
- Nr. i urave dhe i viadukteve	:	21 me 2.566 metra gjatësi
- Nr. i tuneleve rrugore	:	01 me 375 metra gjatësi
- Nr. i pusetave të kullimit	:	110
- Parmakët mbrojtës	:	6,581 m në të majtë dhe 16.068 m në të djathtë
- Mur mbajtës	:	336.200 metra
- Kostoja e parashikuar e ndërtimit	:	US\$ 130.35 milionë
- Periudha e ndërtimit	:	3 vjet



3. Zona e ndërtimit të IDB-së prej 30.9 km është ndarë në dy seksione. SFD-ja ka 9.6 km ndërtim në një seksion. Plani i mëposhtëm përshkruan paraqitjen e përgjithshme të zonave të ndërtimit.



4. Specifikimet e ndërtimit. Specifikimet e rrugës bazohen në standardet italiane të projektimit të rrugëve CNR me një gjerësi prej 12.5 m, që përbëhet sa më poshtë: 2 korsi me 3.75 m, 2 bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe 2 bankina të paasfaltuara.

5. Prerja tërthore është 12 m, 2 korsi me 3.75, 2 bankina 1.5 m dhe 2 kalime për këmbësorë 0.75 m.

6. Pjerrësia maksimale e të gjitha seksioneve më sipër propozohet të jetë 2,5:1 si në seksionet e prerjes ashtu edhe në ato të mbushjes. Rruga e propozuar ndjek kryesisht një vendosje të re.

7. Gjatë gjatësisë së vendit të Projektit, shtresa do të ndërtohet në sipërfaqe të larmishme.

## SHTOJCA II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

### Përshkrimi i Projektit

1. Projekti përbëhet nga dy seksione. QSH-ja, me buxhetin e saj, ka filluar ndërtimin e segmentit të parë të rrugës prej 2.9 km. Projekti në fjalë synon ndërtimin e një rruge 40.5 km të gjatë me dy korsi, që përfshin një tunel 375 m të gjatë me dy kalime. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 m të gjera (7.3 metra mbulimi me asfalt), bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe bankina të paasfaltuara me gjerësi 1 m secila.

2. Objektivat specifike janë: a) sigurimi i lidhjes rrugore më të shkurtër të mundshme me fshatrat e izoluara jugore, kufijtë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Greqisë dhe Europës me Ballkanin e brendshëm; b) shkurtimi i kohës së udhëtimit, koston e operimit të automjeteve dhe rritja e rehatisë, sigurisë dhe besueshmërisë; c) përmbushja e kërkesave të tashme dhe të ardhme të transportit duke përfunduar Korridorin 8; dhe d) të ndihmojë përshpejtimin e aktiviteteve ekonomike, duke përmirësuar aksesin e njerëzve në pikat turistike, mjediset shoqërore, bizneset dhe mundësitë e punësimit që rrjedhin nga ndërlidhja e shtuar e brendshme dhe rajonale.

3. Kostoja e përgjithshme e parashikuar e Projektit është 152.75 milionë USD. Ajo përbëhet nga 42% kostoja e punimeve në rrugë, 23% për ura dhe viadukte, 23% për muret mbajtëse dhe 7% për tunelin. Financimi dhe kostoja totale e vlerësuar e Projektit paraqitet në tabelën 1 më poshtë.

Tabela-1: Parashikimi i Kostos së Projektit dhe Plani i financimit Shumat në Milionë US\$

No.	Komponentët e projektit	IDB (2.9-33.8 km)		Fondi Saudit për Zhvillimin (33.8-43.4 km)		QSH		Kosto Totale
		Shumat	%	Shuma	%	Shuma	%	
1	Përftimi i Tokës dhe Punë të tjera paraprake	-	-	-	-	2.50	100.0%	2.50
2	Punë civile	108.50	83.2%	21.85	16.8%	-	-	130.35
3	Shërbime Konsulence	4.35	83.2%	0.88	16.8%	-	-	5.23
4	Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)	0.55	100.0%	-	0.0%	-	-	0.55
5	Seminar Fillimi dhe Vizitë Familjarizimit	0.14	100.0%	-	0.0%	-	-	0.14
6	Auditim Financiar	0.10	100.0%	-	0.0%	-	-	0.10
<b>Kosto Totale Bazë</b>		<b>113.64</b>	<b>81.8%</b>	<b>22.73</b>	<b>16.4%</b>	<b>2.50</b>	<b>1.8%</b>	<b>138.87</b>
7	Të paparashikuara 10%	11.36	81.8%	2.27	16.4%	0.25	1.8%	13.88
<b>GRAND TOTAL</b>		<b>125.00</b>	<b>81.8%</b>	<b>25.00</b>	<b>16.4%</b>	<b>2.75</b>	<b>1.8%</b>	<b>152.75</b>
Përqindje		81.8%		16.4%		1.8%		100%

**SHTOJCA III**  
**FORMA E OPINIONIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË**  
**(PRINTOHET DHE VENDOSËT NË KOKËN E LETRËS)**

Banka Islamike për Zhvillim  
P.O. Box: 5925, Jeddah 21432  
Kingdom of Saudi Arabia

Të dashur zotërinj,

Në cilësinë time si Ministër Drejtësie i Republikës së Shqipërisë, me kompetencat që më janë dhënë në përputhje me nenin \_\_\_\_ të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore për huan në Republikën e Shqipërisë”, certifikoj që ky dokument përbën mendimin ligjor të lëshuar në lidhje me marrëveshjet e Istisna’a dhe të Agjencisë të datës \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ H (\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ G), të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (Marrëveshje) për ndërtimin e punimeve të përshkruara në shtojcën I të Marrëveshjeve (Sendi) për ta përdorur në ndërtimin e seksionit Qukës Qafë-Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë (Projekti) me një shumë USD 125,000,000/- (njëqind e njëzet e pesë milionë dollarë amerikanë).

Për qëllimin e këtij opinionit ligjor, unë kam shqyrtuar:

- i) marrëveshjet e nënshkruara dhe të dhëna rregullisht nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
- ii) autorizimin për të lidhur dhe nënshkruar marrëveshjet;
- iii) të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet dhe të tjera të Republikës së Shqipërisë; dhe
- iv) ato dokumente dhe instrumente të tjera, që unë i konsiderova të arsyeshme.

Për pasojë, unë jam i mendimit që këto marrëveshje të nënshkruara në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga emër dhe titull/pozicion i nënshkruesit më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ H (\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ G):

- a) janë autorizuar, nënshkruar, dhënë dhe ratifikuar rregullisht nga çdo veprim i nevojshëm korporativ dhe qeveritar;
- b) përbëjnë detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues, të Republikës së Shqipërisë të ekzekutueshme ndaj Republikës së Shqipërisë në përputhje me termat e saj;
- c) nuk kërkojnë ndonjë autorizim, pëlqim, licencë, përjashtim apo heqje dorë tjetër;
- d) nuk shkelin ndonjë dispozitë të Kushtetutës, ndonjë ligj, rregull, rregullore, urdher apo dekret të Republikës së Shqipërisë;

dhe kështu, përbëjnë detyrime detyruese për Republikën e Shqipërisë në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këto marrëveshje.





Për sa më sipër, unë nuk shpreh asnjë mendim tjetër përveç se ndaj ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Bërë më, vendosni datën më \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_ H (që përputhet me \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_ G).

Sinqerisht i juaji,

Nënshkrimi/emri/pozicioni

Nr. i ref. së Projektit: ALB-0107

### **MARRËVESHJE AGJENCIE (ISTISNA'A)**

#### **NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM NË LIDHJE ME NDËRTIMIN E SEKSIONIT QUKËS-QAFË PLOÇË TË KORRIDORIT RRUGOR TIRANË-KORÇË**

Kjo Marrëveshje lidhet më \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_ H (që përputhet me \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_ G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si agjenti (këtu e më poshtë i quajtur “Përfituesi”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu e më poshtë e quajtur “Banka”).

Përfituesi dhe Banka, bashkërisht të quajtura “Palët” dhe individualisht “Pala”.

Duke marrë në konsideratë se:

A. Përfituesi i ka kërkuar Bankës të financojë ndërtimin e punimeve të përshkruara si seksioni i rrugës së financuar nga IDB-ja në aneksin I (këtu e më poshtë të quajtur “Aseti”) për ndërtimin e seksionit Qukës-Qafë Ploçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë (këtu e më poshtë të quajtur “Projekti”), siç përshkruhet në aneksin II;

B. Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës më 29.4.1434H (10.2.2013G) aprovoi një shumë që nuk kalon 125.000.000 USD/- (njëqind e njëzet e pesë milionë USD) për ndërtimin e Asetit për Projektin nëpërmjet Istisna'a;

C. Banka ka rënë dakord në përputhje me marrëveshjen e së njëjtës datë (këtu e më poshtë të quajtur “Marrëveshje Istisna'a”) për ndërtimin e Asetit për Përfituesin, në cilësinë e tij si blerës.

Kështu, Banka dhe Përfituesi bien dakord si më poshtë:

#### **Seksioni 1**

#### **Përkufizime - interpretim**

1.1 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mposhtëm në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin që është pranë tyre më poshtë:

“Shuma e aprovuar”, shuma e specifikuar në paragrafin B më sipër.

“Aseti”, asetet e përshkruara në seksionin rrugor të financuar nga IDB-ja në aneksin I.

“Kostoja kapitale”, kostoja e përgjithshme e ndërtimit të Asetit që do të përfshijë çmimin e Kontratës dhe çdo kosto ose shpenzim tjetër të pësuar nga Banka në ose në lidhje me ndërtimin e Asetit plus një normë shtesë të ndryshueshme LIBOR 6-mujor USD plus 155 pikë bazë në vit të zbatueshëm për çdo disbursim gjatë periudhës së realizimit.

“Marrëveshja e Konsulencës”, marrëveshja për bashkërendimin e ndërtimit të Asetit e lidhur ndërmjet Përfituesit, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese dhe Konsulentit në përputhje me seksionin 4.

“Konsulenti”, firma konsulente ose konsulenti individual që do të caktohet në përputhje me seksionin 4.

“Kontrata”, kontrata(t) për ndërtimin e Asetit të lidhur/a në emër të Bankës nga Përfituesi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese me Kontraktorin(ët).

“Çmimi i Kontratës”, shuma e pagueshme e Kontraktorit për ndërtimin e Asetit.

“Kontraktori”, kontraktori(ët) që u besohet ndërtimi i Asetit.

Data e disbursimit të parë: Data në të cilën Banka kryen disbursimin e parë sipas Kontratës ose Konsulentit cilado të jetë më parë.

“Disbursimi”, pagesa faktike e një pjese të shumës së aprovuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

“Data e hyrjes në fuqi”, data në të cilën Banka deklaron që kjo Marrëveshje ose Marrëveshja Istitucionale (sipas rastit) është në fuqi në përputhje me seksionin 14.

“Agjencia Zbatuese”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

“Certifikata e pranimit përfundimtar”, certifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me termat e Kontratës, që përcakton që ndërtimi i Asetit është përfundimtar në mënyrë të pranueshme nga Kontraktori.

“Periudha e realizimit”, periudha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe që përfundon 4 (katër) vjet më vonë.

“Certifikata e pranimit provizor”, certifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me termat e Kontratës, që përcakton që ndërtimi i Asetit është përfundimtar në mënyrë të pranueshme nga Kontraktori.

“Projekti” ka kuptimin e përshkruar në paragrafin A më sipër.

“Praktika të sanksionueshme”, çdo praktikë korruptive, praktikë e detyruar, praktikë e fshehtë, praktikë mashtruese ose praktikë penguese:

a) “Praktikë korruptive” është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale tjetër;

b) “Praktikë detyruese” është çdo veprim ose mosveprim cenimi ose dëmtimi, ose rreziku për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, një Palë ose pasurinë e palës për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale;

c) “Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, e krijuar për të arritur një qëllim të parregullt, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të parregullt të veprimeve të një pale tjetër;

d) “Praktikë mashtruese” është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpiket të çorientojë me dashje ose nga pakujdesia një palë për të përftuar një përfitim financiar ose tjetër, ose të mënjanojë një detyrim;

e) “Praktikë penguese” është:

i) prishja e qëllimshme, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provave të rëndësishme për hetimin ose bërja e deklarimeve të rreme para hetuesve, me qëllim që të pengohet në mënyrë të konsiderueshme hetimi i Bankës për akuzat e praktikës korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta; dhe/ose kërcënimi, ngacmimi ose trembja e një pale për ta penguar atë në deklarin e njohurive të saj për çështjet e rëndësishme për hetimin ose në ndjekjen e hetimit; ose

ii) veprimet që synojnë të pengojnë në mënyrë të konsiderueshme marrjen nga Banka të informacionit të kërkuar nga Kontrata në lidhje me hetimin e Bankës të akuzave për praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta.

“Taksat”, çdo taksë, detyrim, tarifë apo pagesë tjetër me natyrë të ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo gjobë që paguhet në lidhje me një mospagesë ose vonesë në këtë pagesë).

“Dollar amerikan/USD”, Moneda e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

#### 1.2 Interpretim:

i) një “aneks”, “grafik”, përveç kur tregohet ndryshe, do të interpretohet si referencë ndaj një aneksi, grafiku të marrëveshjes ose dokumenti në të cilin paraqitet një referencë e tillë;

ii) “duke përfshirë” do të interpretohet si një referencë ndaj “duke përfshirë, pa kufizim”;

iii) një “ligj” do të interpretohet si çdo akt ligjor (duke përfshirë ligjin e kodifikuar dhe zakonor), statut, kushtetutë, dekret, vendim, traktat, rregullore, direktivë, akt nënligjor, akt administrativ ose një masë tjetër legjislative e një qeverie përkatese, suprakombëtare, qeverisje lokale, organi rregullator ose ligjor apo gjykatë;



iv) të gjitha referencat ndaj çdo marrëveshjeje (duke përfshirë, pa kufizim, këtë Marrëveshje) apo dokumenti, përfshijnë një referencë ndaj asaj marrëveshjeje apo dokumenti të ndryshuar, plotësuar, zëvendësuar, rinovuar ose caktuar;

v) “nen”, “seksion”, “paragraf” ose “preambulë”, përveç kur përcaktohet ndryshe, do të interpretohet si i kësaj ose për këtë Marrëveshje;

vi) titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk kanë si synim e nuk do të interpretohen për të ndryshuar, kufizuar apo zgjeruar në ndonjë mënyrë objektin ose kuptimin e gjuhës së përdorur në këtë Marrëveshje;

vii) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjellas;

viii) një “ditë” dhe “vit” është një ditë, muaj dhe vit, përkatësisht i kalendarit gregorian; dhe

ix) fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen Istisna’a dhe që nuk përkufizohen këtu kanë të njëjtin kuptim si në Marrëveshjen Istisna’a.

## Seksioni 2

### Agjencia

Banka, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje cakton Përfituesin si agjentin e saj për të lidhur Kontratën nëpërmjet Agjencisë Zbatuese me Kontraktorin dhe të mbikëqyrë ndërtimin e Asetit, dhe Përfituesi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje bie dakord me këtë caktim.

## Seksioni 3

### Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve

3.1 Është rënë dakord ndërmjet Palëve nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, që Përfituesi, në konsultim me Bankën dhe në përputhje me procedurat e prokurimit të Bankës dhe me aprovimin e saj, të japë të gjitha kontratat e financuara nga kjo Marrëveshje për ekzekutimin e Projektit, si më poshtë:

i) Prokurimi i punimeve civile sipas komponentit të financuar nga IDB-ja do të ndahet në dy paketat e mëposhtme dhe do të kryhet nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar të kufizuar për vendet anëtare të IDB-së me parakualifikim të ofertuesve sipas përcaktimit në udhëzimet e IDB-së për prokurimin e mallrave dhe punimeve:

Paketa 1: 2.9 km deri 18.0 km (gjatësia e përgjithshme 15.1 km).

Paketa 2: 18.0 km deri 33.8 km (gjatësia e përgjithshme 15.8 km).

ii) Firmave u lejohe të kualifikohen dhe të ofertojnë për të dyja paketat, me kusht që ato të përmbushin kriteret përkatëse të kualifikimit.

iii) Një konsulent për rishikimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e Projektit për paketat 1 dhe 2 do të zgjidhet nga një listë e shkurtër prej 6 deri 8 firma konsulence, të kufizuara në vendet anëtare të IDB-së nëpërmjet procedurave të zgjedhjes, bazuar në cilësi dhe kosto (QCBS), siç përcaktohen në udhëzimet e IDB-së për përdorimin e konsulentëve.

iv) Audituesi financiar i Projektit do të zgjidhet nga një listë e shkurtër e firmave lokale të auditit nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes me koston më të ulët (LCS) sipas përcaktimit në udhëzimet e IDB-së për përdorimin e konsulentëve.

v) Personeli i PMU-së do të zgjidhet si ekspertë individualë nëpërmjet krahasimit të kualifikimeve të minimalisht tre ekspertëve lokalë për çdo pozicion.

3.2 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, do të sigurojë ose do të marrë masa për sigurimin e përfshirjes së dispozitave të pranueshme për Bankën kundër korrupsionit dhe mashtrimit në të gjitha dokumentet dhe kontratat e ofertimit, duke përfshirë dispozita që specifikojnë të drejtën e Bankës për të audituar dhe shqyrtuar regjistrat dhe llogaritë e agjencive zbatuese dhe ekzekutuese dhe të gjithë kontraktorëve, furnitorëve, konsulentëve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve që lidhen me Projektin.

#### Seksioni 4

### Përzgjedhja e Kontraktorit dhe e Konsulentit

4.1 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese dhe në emër të Bankës, do të negociojë dhe do të përfundojë një Kontratë me Kontraktorin, duke iu nënshtruar sa më poshtë:

- i) Termat dhe kushtet e Kontratës do të miratohen bashkërisht nga Banka dhe Përfituesi;
- ii) Çmimi i Kontratës nuk do të kalojë 125.000.000 USD (njëqind e njëzet e pesë milionë dollarë amerikanë);
- iii) Periudha për përfundimin e ndërtimit të Asetit sipas Kontratës, nuk do të tejkalojë 48 (dyzet e tetë) muaj nga data e disbursimit të parë;
- iv) Specifikimet e Asetit sipas Kontratës janë ato të përshkruara shkurtimisht në aneksin I dhe me hollësi në Kontratë;
- v) Pas përfundimit, Aseti do të merret në dorëzim drejtpërdrejt nga Përfituesi;
- vi) Aprovimi me shkrim i Bankës për termat dhe kushtet e kontratës së negociuar do të merret para përfundimit të Kontratës nga Përfituesi;
- vii) Kontrata do të parashikojë që Kontraktori të prokurojë një sigurim për të gjitha risqet e Kontraktorit, siç është e zakonshme në këtë aktivitet, dhe shumat e siguracionit do t'i paguhen Bankës në dollarë amerikanë ose në çdo monedhë tjetër të pranueshme;
- viii) Kontrata mund të përcaktohet në lekë shqiptarë.

4.2 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese dhe në emër të Bankës, do të negociojë dhe do të përfundojë një kontratë me Konsulentin, duke iu nënshtruar sa më poshtë:

- i) Konsulenti do të jetë përgjegjës për të verifikuar të gjitha kërkesat që duhet të bëhen nga Banka. Ky konsulent do të jetë përgjegjës edhe për bashkërendimin e të gjitha aktivitetëve, paraqitjen e raporteve periodike të progresit dhe për garantimin që politikat dhe procedurat e Bankës respektohen rigorozisht gjatë gjithë punëve për Asetin;
- ii) Termat e referencës së Kontratës së Konsulentit do të miratohen me shkrim ndërmjet Përfituesit dhe Bankës para ftesës për propozime nga lista e shkurtër e konsulentëve;
- iii) Përfituesi do ta përfshijë Bankën në bisedimet me Konsulentin e përzgjedhur; rezultati i të cilave do t'i nënshtrohet aprovimit përfundimtar të Bankës dhe Përfituesit;
- iv) Kontrata e Konsulentit mund të përcaktohet në lekë shqiptarë.

#### Seksioni 5

### Menaxhimi i kontratave

5.1 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit, merr përsipër që gjatë menaxhimit të Kontratës, ai do të zbatojë standardin më të lartë të zellit dhe kujdesit në monitorimin e përmbushjes së saktë dhe korrekte nga Kontraktori të detyrimeve sipas Kontratës, me qëllim garantimin që Aseti do të ndërtohet në përputhje me specifikimet brenda afatit dhe për çmimin e parashikuar në Kontratë.

5.2 Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, nuk do të bëjë amendime, ndryshime ose modifikime të Kontratës që mund:

- i) të rezultojnë në rritjen e çmimit të Kontratës; ose
- ii) të rezultojnë në shtyrjen e datës së përfundimit; ose
- iii) të rezultojnë në ndryshimin e specifikimit; ose
- iv) të mos jetë në përputhje me praktikën e zakonshme të mira.

5.3 Pa cenuar përgjithësimin e seksionit 5.1, Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit, do të jetë i detyruar:

- i) të vërë në dijeni Bankën, sapo të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, për çdo vonesë ose vonesë të parashikuar në përfundimin e ndërtimit të Asetit me hollësi të plota për të;



ii) të merret me çështjet rregullatore dhe administrative në lidhje me ndërtimin e Asetit në përputhje me ligjet përkatëse në Republikën e Shqipërisë;

iii) të nënshkruajë certifikatën e pranimit paraprak dhe certifikatën e pranimit përfundimtar nëse ai është i bindur që Aseti në gjendjen përkatëse është kryer në përputhje me Kontratën, duke përfshirë specifikimet.

5.4 Nëse në shkelje të seksionit 5, Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit, i jep udhëzime Kontraktorit si rezultat i të cilave ka një rritje në çmimin e Kontratës ose Banka bëhet përgjegjëse kundrejt një pale për një pretendim, humbje, dëm apo shpenzim, atëherë Përfituesi bie dakord të përballojë rritjen e çmimit të Kontratës, ose sipas rastit, të zhdëmtojë Bankën për çdo dëm, humbje, pretendim apo shpenzim të tillë.

5.5 Është rënë dakord që Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit, do të vërë në dispozicion atë numër nga personeli i tij që do të jetë i nevojshëm për të përmbushur detyrat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas Kontratës.

5.6 Përfituesi nuk ka të drejtë të marrë asnjë shpërblim apo pagesë tjetër nga Banka në lidhje me ose që rrjedh nga caktimi i Përfituesit si mbikëqyrës i Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje.

## Seksioni 6

### **Disbursimi i shumës së aprovuar**

6.1 Banka do të disbursojë shumën e aprovuar në mënyrën e parashikuar në Kontratë dhe në përputhje me procedurat e disbursimit të Bankës.

6.2 Data e kërimit të disbursimit të parë: Nëse brenda 180 ditëve nga data e hyrjes në fuqi ose një datë e mëvonshme që do të bihet dakord ndërmjet Përfituesit dhe Bankës, Përfituesi nuk i ka paraqitur një kërkesë Bankës për të bërë disbursimin e parë, Banka mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje, duke i bërë njoftimin përkatës Përfituesit.

6.3 Data e mbylljes së livrimit: 30.10.2017G, ose një datë e mëvonshme që do të bihet dakord ndërmjet Përfituesit dhe Bankës si datë mbylljeje për tërheqjet sipas kësaj Marrëveshjeje.

6.4 Pa cenuar përgjithësimin e seksionit 6.1, Përfituesi nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit:

i) gjatë paraqitjes së kërkesës për disbursimin e parë Konsulentit, paraqet një kopje të Marrëveshjes së nënshkruar të Konsulencës;

ii) gjatë paraqitjes së kërkesës për disbursimin e parë sipas Kontratës, paraqet një kopje të nënshkruar të Kontratës (nëse nuk është paraqitur më parë) dhe një kopje të policës së sigurimit.

6.5 Konsulenti do të verifikojë kërkesat që duhet të bëhen nga Banka.

6.6 Banka nuk do të jetë e detyruar të bëjë asnjë disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kërkesa për disbursim nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje ose nëse dokumentet paraqitur nga Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit janë të paplota apo me mangësi. Përfituesi është përgjegjës për çdo vonesë në kryerjen e disbursimit, nëse kjo vonesë është për shkak se kërkesa nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje apo për shkak të pamjaftueshmërisë ose mospërputhjes së dokumenteve të kërkuara.

## Seksioni 7

### **Marrja në dorëzim e Asetit**

7.1 Është rënë dakord që Kontrata do të parashikojë marrjen në dorëzim të Asetit pas përfundimit drejtpërdrejt nga Përfituesi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit. Është rënë, gjithashtu, dakord që në asnjë rast Banka nuk do të jetë e detyruar ndaj Përfituesit për ndonjë humbje që rrjedh nga ndonjë vonesë në marrjen në dorëzim të sendit.

7.2 Për mënjanimin e dyshimit, bihet dakord, që nëse Përfituesi, pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, refuzon të marrë në dorëzim Asetin nga Kontraktori për një

shkak çfarëdo, Përfituesi do të zhdëmtojë Bankën për çdo kosto, shpenzim apo humbje, që rrjedh nga kjo.

## Seksioni 8 Pezullimi, anulimi dhe përfundimi

8.1 Nëse brenda 180 (një qind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi, Kontrata nuk nënshkruhet apo Përfituesi nuk ka kërkuar disbursimin e parë, Banka, duke njoftuar Përfituesin, mund të anulojë shumën e aprovuar, përveç kur është e pranon justifikimin e Përfituesit për këtë vonesë.

8.2 Përfituesi mund t'i kërkojë Bankës t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje dhe të anulojë shumën e aprovuar ose një pjesë të saj në çdo kohë para nënshkrimit të Kontratës.

8.3 Në çdo kohë që Banka vendos, pas konsultimit me Përfituesin, që një pjesë e shumës së aprovuar nuk do të jetë e nevojshme për të financuar Projektin, Banka mund të njoftojë Përfituesin për shfuqizimin e detyrimit të Bankës për të disbursuar këtë pjesë. Kjo pjesë e shumës së aprovuar do të konsiderohet e anuluar me dorëzimin e këtij njoftimi.

8.4 Me dorëzimin e Asetit dhe lëshimin e certifikatës së pranimi, detyrimet e agjencisë për Përfituesin sipas kësaj Marrëveshjeje do të shkarkohen.

8.5 Banka, me njoftim drejtuar Përfituesit, mund të pezullojë ose të anulojë shumën e aprovuar ose një pjesë të saj në një prej rasteve të mëposhtme:

a) Ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila:

i) sipas mendimit të Bankës do ta bëjë të pamundur që Përfituesi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) do të pengojë arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo Marrëveshje.

b) Një përfaqësim i bërë nga Përfituesi ose një deklaram i dhënë dhe që duhet të merrej për bazë nga Banka në përpunimin e Projektit për aprovimin ose për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, ka qenë i paplotë ose i pasaktë në një aspekt material.

c) Banka përcakton se:

i) Përfituesi është në shkelje të një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) në lidhje me prokurimin e ekzekutimit të çdo kontrate, që duhet të financohet plotësisht ose pjesërisht nga shumat e financimit, nëse një person ose subjekt është përfshirë në ndonjë praktikë të sanksionueshme dhe Përfituesi nuk ka marrë masa të përshtatshme dhe në kohë, të pranueshme për Bankën, për të korrigjuar situatën ose për t'i zgjidhur këto praktika kur ato ndodhin.

d) Përfituesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij për të paguar një shumë që kërkohet nga Banka (ose çdo organ i anëtarësuar me Bankën).

8.6 Nëse ndonjë prej ngjarjeve të specifikuar në paragrafët (a) deri në (d) të nenit 8.5 ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, pastaj në çdo kohë të mëvonshme gjatë vazhdimi të ngjarjes, Banka, duke njoftuar Përfituesin mund ta ndërpresë Kontratën.

8.7 Çdo pezullim i shumës së aprovuar do të vazhdojë derisa ngjarja ose ngjarjet, që kanë shkaktuar pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Banka të ketë njoftuar Përfituesin, që angazhimi i Bankës për të ndërtuar Asetin është rivendosur, cilado të ndodhë më parë; megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi të tillë rivendosjeje, angazhimi për të ndërtuar Asetin do të rivendoset vetëm në masën dhe në përputhje me kushtet e specifikuar në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk ndikon ose cenon ndonjë të drejtë, tagër apo mjet mbrojtës të Bankës në lidhje me një ngjarje tjetër ose pasuese të përshkruar në këtë seksion.

8.8 Në rast se Kontraktori nuk përmbush një prej detyrimeve të tij sipas Kontratës dhe Përfituesi, në konsultim me Bankën, e përfundon Kontratën në përputhje me kushtet e saj, ky përfundim pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga kjo zgjidhje do të ketë efektin e anulimit të çdo shume të mbetur të padisbursuar nga shuma e aprovuar, përveç kur Banka bie dakord ndryshe. Pavarësisht



përfundimit të Marrëveshjes, Përfituesi do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të ndihmojë Bankën në përfitim nga Kontraktori të atyre shumave të çmimit të Kontratës dhe çdo shume tjetër që mund të jetë disbursuar nga Banka para përfundimit të Kontratës.

8.9 Anulimi i shumës së aprovuar ose një pjese të saj nuk do të ketë ndikim në angazhimet e bëra, detyrimet e marra përsipër apo të drejtat e lindura para datës së anulimit.

8.10 Përveç kur disbursimi është bërë nga shuma e aprovuar, nëse shuma e aprovuar ose një pjesë e saj anulohet në përputhje me këtë seksion, Marrëveshja do të konsiderohet automatikisht e përfunduar.

8.11 Me anulimin e shumës së aprovuar ose një pjese të saj dhe/ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje për shkak të një rasti të mosplotësimit të detyrimeve ose të shkeljes nga Përfituesi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose mospagimit të dorëzimit të Asetit, Përfituesi do ta zhdëmtojë Bankën me një shumë të barabartë me koston kapitale dhe angazhimin e përcaktuar ose të pësuar në datën e përfundimit.

8.12 Kjo Marrëveshjeje do të përfundojë automatikisht me prishjen e Marrëveshjes Istisna'a ose anulimin e shumës së aprovuar ose një pjese të saj sipas Marrëveshjes Istisna'a.

## Seksioni 9 Përfaqësime

Përfituesi përfaqëson dhe garanton që:

i) të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet të çdo lloji, të nevojshme për të autorizuar ose që kërkohen për vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje kundrejt Republikës së Shqipërisë janë siguruar ose kryer dhe janë të vlefshme dhe në fuqi të plotë;

ii) sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje, pretendimet e Bankës kundrejt Përfituesit, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për çdo qenie në borxh të Përfituesit; dhe

iii) departamenti ose njësia përkatëse e ngarkuar me shërbimin e borxhit të jashtëm, është udhëzuar për të bërë pagesa nga këstet e çmimit të shitjes në datat e kërkueshme.

## Seksioni 10 Raste të mosplotësimit të detyrimeve

10.1 Nëse një nga rastet e specifikuar në këtë seksion do të ketë ndodhur dhe nuk ndërpritet, Banka me njoftim drejtuar Përfituesit, mund të deklarojë që i gjithi ose një pjesë e çmimit të shitjes do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm, dhe ky bëhet i tillë (pavarësisht parashikimeve në këtë Marrëveshje) pa ndonjë njoftim të mëtejshëm:

a) ka mungesë të pagesës së ndonjë kësti të çmimit të shitjes dhe ky mosplotësim detyrimi vazhdon për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh;

b) një mungesë, e ndryshme nga mungesa e specifikuar në seksionin 10.1(a), ka ndodhur në përmbushjen e ndonjë detyrimi të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo mungesë e tillë ka vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh;

c) një përfaqësim apo garanci e konfirmuar, apo e bërë nga Përfituesi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje, ose në lidhje me ndonjë kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të gjendet të ketë qenë e pasaktë në aspektin material dhe do të vazhdojë të jetë e pasaktë për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit të dhënë për këtë Përfituesit nga Banka;

d) Përfituesi nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e tij, kur bëhen të kërkueshme apo nuk do të jetë i aftë për të paguar; ose ndonjë kreditor do t'i ketë marrë posedimin ligjërisht apo do të jetë emëruar një administrator për të gjithë ose një pjesë të detyrimeve ose asetëve të Përfituesit; ose një masë zbatuese apo ekzekutive (ose proces i ngjashëm) do të jetë zbatuar apo është vendosur për sendet pasurore të Përfituesit dhe kjo masë zbatuese ose ekzekutim nuk do të jetë hequr për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë; ose do të jetë nxjerrë një urdhër apo do të jetë miratuar një rezolutë apo procedurë tjetër e ngjashme për likuidimin, falimentimin ose shkrirjen e Përfituesit; ose do të ketë ndodhur një ngjarje tjetër, që sipas ligjit të zbatueshëm do të ketë efekt të ngjashëm si ato të rasteve të renditura më sipër në këtë paragraf;

e) ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e paekzekutueshme.

10.2 Nëse ka ndodhur ndonjë rast i mosplotësimit të detyrimeve ose ndonjë ngjarje, e cila në bazë të parashikimit ose njoftimit dhe parashkrimit, do të bëhej një rast i mosplotësimit të detyrimeve, Përfituesi do të njoftojë menjëherë Bankën për këtë me faks, duke përcaktuar natyrën e këtij rasti të mosplotësimit të detyrimeve ose ndonjë ngjarje tjetër dhe secilin prej hapave që Përfituesi po ndërmerr për ta korrigjuar atë.

10.3 Asnjë mënyrë veprimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte, tagri apo mjeti që i takon Bankës, në rastin e një mosplotësimi detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo marrëveshjeje tjetër, nuk do ta cenojë këtë të drejtë, tagër apo mjet dhe nuk do të interpretohet sikur hiqet dorë prej saj apo sikur kjo tolerohet; asnjë veprim i Bankës në lidhje me këtë qenie në vonesë apo tolerim të saj, nuk cenon apo dëmton ndonjë të drejtë, tagër apo mjet të Bankës në lidhje me çdo rast mosplotësimi të detyrimeve.

## Seksioni 11 Zhdëmtimi

11.1 Përfituesi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje merr përsipër të zhdëmtojë Bankën, në bazë neto pa tatime (me normat e zbatueshme të tatimeve lokale dhe të huaja) kundrejt, dhe bie dakord të mbrojë e ta mbajë të padëmtuar Bankën nga të gjitha detyrimet, tarifatat, humbjet, dëmet, gjobat, kërkesat, paditë, vendimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifatat dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore (duke përfshirë ato tarifata dhe shpenzime ligjore, që shkaktohen në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje), të çdo lloji dhe natyre, sido që të jenë vendosur, pësuar nga apo ngarkuar Bankës që rrjedh nga:

a) pronësia, posedimi, përdorimi, dokumentimi, heqja, kthimi ose aplikime apo disponime të tjera sipas Kontratës ose Marrëveshjes së Konsulencës, duke përfshirë ato që rrjedhin nga:

- i) ndonjë humbje ose dëmtim i ndonjë prone apo vdekje apo dëmtim i ndonjë personi;
- ii) patentat apo defektet e fshehura në Aset;
- iii) çdo pretendim që bazohet në detyrim nga një veprim i paligjshëm apo tjetër;
- iv) çdo pretendim bazuar në një shkelje të një patente, marke tregtare ose të drejte autori;
- v) çdo pretendim i bazuar në detyrime që rrjedhin nga ligjet e zbatueshme mjedisore ose aprovimet mjedisore;
- vi) çdo pretendim në lidhje me titullin e Asetit ose tokën në të cilën është ndërtuar;
- vii) çdo pretendim ose mosmarrëveshje në lidhje me Kontratën ose çdo letër kredie të vendosur sipas ose në lidhje me Marrëveshjen e Konsulencës;

b) ndodhinë e ndonjë mosplotësimi detyrimi ose ndonjë mospërbushje tjetër nga ana e Përfituesit ose Kontraktorit për të përmbushur ose për të respektuar ndonjë term të kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur në lidhje me të apo përndryshe në lidhje me Asetin, por duke përjashtuar çdo pretendim të bazuar në një mosveprim nga ana e Bankës për të respektuar detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë dokumenti, marrëveshjeje apo kontrate të lidhur nga Banka në lidhje me të ose përndryshe në lidhje me Asetin;





c) çdo pretendim, rëndim, mjet sigurie padie, peng ose proces gjyqësor në lidhje me titullin e ose interesin në Aset ose tokën ku ai është ndërtuar.

11.2 Përfituesi do t'i bëjë Bankës njoftim të menjëhershëm për çdo ndodhi apo kusht në dijeni të Përfituesit, si pasojë e të cilit Banka është ose mund të ketë të drejtën të zhdëmtohet. Zhdëmtimi i parashikuar në seksionin 11.1 do të zbatohet specifikisht dhe do të përfshijë pretendimet dhe paditë e ngritura nga ose në emër të punonjësve të Përfituesit dhe Përfituesi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje heq dorë shprehimisht, kundrejt Bankës, nga çdo imunitet ndaj të cilit përndryshe Përfituesi do të kishte të drejtë sipas ligjeve të zbatueshme. Përfituesi, me kërkesë të Bankës (por në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga kjo kërkesë) do të rimbursojë menjëherë Bankën për shumat e shpenzuara në lidhje me sa më sipër ose pagesën e këtyre shumave drejtpërdrejt. Përfituesit do t'i kalojnë të drejtat e Bankës për çdo çështje në lidhje me të cilat Përfituesi ka rimbursuar Bankën për shumat e shpenzuara prej tij ose që i ka paguar faktikisht këto shuma drejtpërdrejt në përputhje me seksionin 9. Në rast se kundër Bankës është ngritur ndonjë padi apo ka filluar ndonjë gjykim në lidhje me ndonjë pretendim për zhdëmtim, Banka, pas marrjes së njoftimit të fillimit të këtij gjykimi apo padie, do të njoftojë për këtë Përfituesin, duke përfshirë një kopje të të gjitha dokumenteve që i janë dërguar Bankës. Përfituesi, me kërkesën e Bankës, mund të kundërshtojë ose të mbrojë këtë padi ose gjykim me shpenzimet e Përfituesit, ose të marrë masa për kundërshtimin ose mbrojtjen me një këshilltar të zgjedhur nga Përfituesi, që është normalisht i pranueshëm për Bankën. Në rastin e moskryerjes së kësaj nga Përfituesi, Përfituesi do të paguajë të gjitha shpenzimet dhe kostot (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit), që pësohen nga Banka në lidhje me këtë padi ose gjykim.

## Seksioni 12

### Raportet

Përfituesi, ndërmjet Agjencisë Zbatuese, merr përsipër të paraqesë ose merr masa për paraqitjen e raporteve të mëposhtme drejtuar Bankës:

i) Brenda 3 (tre) muajve pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe pas kësaj në çdo tre muaj, një raport mbi progresin dhe zbatimin e Kontratës, në mënyrën që mund të specifikojë Banka herë pas here;

ii) Menjëherë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, por jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të kësaj certifikate, lëshon një raport përfundimi me objektin dhe detajet që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka për ndërtimin e Asetit dhe operimin fillestar të Projektit;

iii) Një raport vjetor auditimi nga audituesi financiar i Projektit. Ky raport do të jepet përgjatë gjithë periudhës së realizimit dhe periudhës së pagesës së çmimit të shitjes sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

iv) Çdo raport ose informacion tjetër që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

## Seksioni 13

### Heqja dorë

Mosushtrimi ose mostheksimi nga Banka i të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesa e saj për këto apo mosushtrimi, apo mostheksimi i ndonjë mjeti që ajo mund të ketë ndaj Përfituesit ose ndonjë vonesë për këtë, nuk do ta cenojë këtë të drejtë ose mjet dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet.

Seksioni 14  
**Efektiviteti**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e hyrjes në huqi të Marrëveshjes Istisna'a.

Seksioni 15  
**Ligji i zbatuar - zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

15.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me parimet e Shari'ah Islamik, siç janë shprehur në Islamic Fiqh Academy, siç shprehen në Standardet e Shari'ah të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI) dhe siç interpretohet nga Komiteti Shari'ah i Bankës.

15.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim i një Pale drejtuar Palës tjetër, që rrjedh nga kjo Marrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje ndërmjet Palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i një Palë drejtuar tjetrës, i paraqitet një paneli arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyruet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Islamike Ndërkombëtare për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s do të zbatohen në mungesë të një procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë pretendimi nga një Palë kundrejt tjetrës. Gjuha angleze do të përdoret gjatë gjithë procedurës së gjykimit në arbitrazh.

15.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi kopje të vendimit t'u jenë dhënë Palëve, vendimi nuk zbatohet, çdo Palë mund të kërkojë urdhër ekzekutimi ose të fillojë një procedurë për të ekzekutuar vendimin në çdo gjykatë me juridiksion kompetent ndaj palës tjetër, mund të zbatojë këtë vendim me ekzekutim të detyruar ose mund të ndjekë një mjet tjetër kundrejt palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

15.4 Çdo Palë në këtë Marrëveshje bie dakord që çdo vendim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje kundrejt saj mund të ekzekutohet ndaj fondeve të saj (aseteve) në çdo juridiksion. Palët në këtë Marrëveshje heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që ato mund të kenë për një padi, veprim apo gjykim, që rrjedh nga ose në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse përcillet në një juridiksion ku ajo ka fonde (asete) dhe nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim që një padi, veprim apo gjykim i tillë, i sjellë në një juridiksion të caktuar, është ngritur në një mënyrë të papërshtatshme.

15.5 Në masën që një Palë në këtë Marrëveshje mund të pretendojë në një juridiksion për vete ose asetet e saj imunitet nga padia, ekzekutimi, sequestrimi (paraprak apo si ekzekutim para një vendimi arbitrazhi apo gjyqësor ose ndryshe) apo nga një proces gjyqësor tjetër ose në masën që në një juridiksion të tillë mund t'i vishet asaj vetë ose asetëve të saj, ky imunitet (i pretenduar apo jo), kjo Palë bie dakord në mënyrë të pakthyeshme për të mos e pretenduar dhe në këtë mënyrë heq dorë nga ky imunitet.

Seksioni 16  
**Bashkërendimi dhe njoftimet**

16.1 Bashkërendimi: Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë si përfaqësuesi i autorizuar i Përfituesit (Përfaqësuesi i Përfituesit) do të përfaqësojë Përfituesin për të gjitha çështjet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të gjitha qëllimet dhe synimet pa kufizim, përkatësisht:

i) të mbajë marrëdhëniet me Bankën dhe të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që i takojnë Përfituesit në saje të kësaj Marrëveshjeje.

ii) të gjitha komunikimet e çdo lloji, që i jepen nga Banka Përfaqësuesit të Përfituesit, do të konsiderohen t'i jenë dhënë rregullisht Përfituesit;



iii) të gjitha komunikimet e marra prej Bankës nga Përfaqësuesi i Përfituesit, do të konsiderohen të jenë dhënë ose bërë rregullisht nga dhe të marra nga Përfituesi; dhe

vi) Përfaqësuesi i Përfituesit do të kryejë në çdo kohë bashkërendim dhe bashkëpunim të efektshëm dhe të rregullt, dhe do të garantojë që Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të kryejnë rregullisht detyrat e tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

16.2 Njoftimet. Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër që jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me të, bëhet me shkrim dhe konsiderohet të jetë dhënë rregullisht nëse jepet dorazi, me postë ajrore, me shërbim korrieri ose faks drejtuar Palës që i adresohet në atë adresë të Palës që specifikohet më poshtë ose në një adresë tjetër që kjo palë ka përcaktuar, duke i bërë njoftim palës që i bën këtë njoftim, kërkesë apo komunikim.

Për Përfituesin:  
Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: +355 4 22 28 405  
Fax: +355 4 22 58 494  
E-mail: sekretariazv1@minfin.gov.al

Për Agjencinë Zbatuese:  
Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Ministria e Punëve Publike  
dhe Transportit  
Rruga “Sami Frashri”, nr. 33  
Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: +355 4 22 34 702  
Fax: +355 4 22 23 600

Për Bankën:  
P.O. Box 5925  
Jeddah-21432  
Kingdom of Saudi Arabia  
Tel: +966 2 6361400  
Fax: +966 2 6366871  
E-mail: [archives@isdb.org](mailto:archives@isdb.org)

## Seksioni 17 Të ndryshme

17.1 Paragrafët dhe anekset përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Autoriteti: Personi që nënshkruan këtë Marrëveshje në emër të cilësdo Palë që përfaqëson dhe garanton Palën tjetër që ai ose ajo ka tagrin dhe autoritetin e kërkuar ligjor për të nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Palës dhe ua nënshtron Palën detyrimeve të saj.

17.3 Tërësia e Marrëveshjes: Kjo Marrëveshje është marrëveshja e plotë dhe mbizotëron mbi çdo marrëveshje ose komunikim me shkrim apo me gojë ndërmjet Palëve në lidhje me këtë objekt.

17.4 Ndryshime: Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve.

Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit, nuk do të kërkojnë aprovimin paraprak të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

17.5 Data e Marrëveshjes: Data e kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të jetë ajo që shfaqet në preambulë.

(FUNDI I NENEVE)

Faqja e nënshkrimit:

Në dëshmi të kësaj, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në lidhje me financimin e Asetit në lidhje me ndërtimin e seksionit

Qukës-Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë për një shumë që nuk kalon 125.000.000 USD (njëqind e njëzet e pesë milionë dollarë amerikanë) në datën e shkruar më sipër. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, ku secila palë merr një kopje të nënshkruar rregullisht të saj.

**PËR DHE NË EMËR TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Emri:  
Titulli:

**PËR DHE NË EMËR TË  
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

Emri:  
Titulli:

**ANEKSI I  
PËRSHKRIMI I ASETIT**


1. Projekti gjendet në korridorin e transportit Lindje-Perëndim të Shqipërisë. Projekti synon ndërtimin e një rruge 40.5 km të gjatë me dy korsi, që përfshin një tunel 375 m të gjatë me dy kalime ndërmjet Qukësit dhe Qafë-Plloçës. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e Projektit është 152.75 milionë USD. Ajo përbëhet nga 42% kosto për punimet në rrugë, 23% për ura dhe viadukte, 23% për muret mbajtëse dhe 7% për tunelin.

2. Seksioni i financuar nga IDB-ja është 30.9 km i gjatë dhe ka një tunel të gjatë 375 m me dy kalime. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 m të gjera (7.3 metra mbulimi me asfalt), 2 bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe 2 bankina të paasfaltuara me gjerësi 1 m secila. Projekti do të përmirësojë 8 km ekzistues fillestarë dhe rreth 32.5 km gjatësi do të jetë ndërtimi i ri. Kostoja e vlerësuar e seksionit të financuar nga IDB-ja është 125.0 milionë USD.

3. Objekti i përgjithshëm i punimeve civile prej 40.5 km rrugë me dy kalime do të përfshijë:

- Gjatësia e rrugës : 40.5 km
- Nr. i urave dhe i viadukteve : 21 me 2.566 metra gjatësi
- Nr. i tuneleve rrugore : 01 me 375 metra gjatësi
- Nr. i pusetave të kullimit : 110
- Parmakët mbrojtës : 6.581 m në të majtë dhe 16.068 m në të djathtë
- Mur mbajtës : 336.200 metra
- Kostoja e parashikuar e ndërtimit : US\$ 130.35 milionë
- Periudha e ndërtimit : 3 vjet

4. Zona e ndërtimit të IDB-së prej 30.9 km është ndarë në dy seksione. SFD-ja ka 9.6 km ndërtim në një seksion. Plani i mëposhtëm përshkruan paraqitjen e përgjithshme të zonave të ndërtimit.



5. Specifikimet e ndërtimit: Specifikimet e rrugës bazohen në standardet italiane të projektimit të rrugëve CNR me një gjerësi prej 12.5 m, që përbëhet sa më poshtë: 2 korsi me 3.75 m, 2 bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe 2 bankina të paasfaltuara.

6. Prerja tërthore është 12 m, 2 korsi me 3.75 m, 2 bankina 1.5 m dhe 2 kalime për këmbësorë 0.75 m.

7. Pjerrësia maksimale e të gjitha seksioneve më sipër propozohet të jetë 2,5:1, si në seksionet e prerjes ashtu edhe në ato të mbushjes. Rruga e propozuar ndjek kryesisht një vendosje të re.

8. Gjatë gjatësisë së vendit të Projektit, shtresa do të ndërtohet në sipërfaqe të larmishme.

## ANEKSI II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Projekti përbëhet nga dy seksione. QSH-ja me buxhetin e saj ka filluar ndërtimin e segmentit të parë të rrugës prej 2.9 km. Projekti në fjalë synon ndërtimin e një rruge 40.5 km të gjatë me dy korsi, që përfshin një tunel 375 m të gjatë me dy kalime. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 m të gjera (7.3 metra mbulimi me asfalt), bankina të asfaltuara me gjerësi 1.5 m secila dhe bankina të paasfaltuara me gjerësi 1 m secila.

2. Objektivat specifikë janë: a) sigurimi i lidhjes rrugore më të shkurtër të mundshme me fshatrat e izoluar jugore, kufijtë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Greqisë dhe Europës me Ballkanin e brendshëm; b) shkurtimi i kohës së udhëtimit, kostos së operimit të automjeteve dhe rritja e rehatisë, sigurisë dhe besueshmërisë; c) përmbushja e kërkesave të tashme dhe të ardhme të transportit, duke përfunduar Korridorin 8; dhe d) të ndihmojë përsheptimin e aktiviteteve ekonomike, duke përmirësuar aksesin e njerëzve në pikat turistike, mjediset shoqërore, bizneset dhe mundësitë e punësimit, që rrjedhin nga ndërlidhja e shtuar e brendshme dhe rajonale.

3. Kostoja e përgjithshme e parashikuar e Projektit është 152.75 milionë USD. Ajo përbëhet nga 42% kostoja e punimeve në rrugë, 23% për ura dhe viadukte, 23% për muret mbajtëse dhe 7% për tunelin. Financimi dhe kostoja totale e vlerësuar e Projektit paraqitet në tabelën 1 më poshtë.

Tabela-1: Parashikimi i Kostos së Projektit dhe Plani i financimit Shumat në Milionë US\$

No.	Komponentët e projektit	IDB (2.9-33.8 km)		Fondi Saudit për Zhvillimin (33.8-43.4 km)		QSH		Kosto Totale
		Shumat	%	Shuma	%	Shuma	%	
1	Përftimi i Tokës dhe Punë të tjera paraprake	-	-	-	-	2.50	100.0%	2.50
2	Punë civile	108.50	83.2%	21.85	16.8%	-	-	130.35
3	Shërbime Konsulence	4.35	83.2%	0.88	16.8%	-	-	5.23
4	Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)	0.55	100.0%	-	0.0%	-	-	0.55
5	Seminar Fillimi dhe Vizitë Familjarizimit	0.14	100.0%	-	0.0%	-	-	0.14
6	Auditim Financiar	0.10	100.0%	-	0.0%	-	-	0.10
<b>Kosto Totale Bazë</b>		<b>113.64</b>	<b>81.8%</b>	<b>22.73</b>	<b>16.4%</b>	<b>2.50</b>	<b>1.8%</b>	<b>138.87</b>
7	Të paparashikuara 10%	11.36	81.8%	2.27	16.4%	0.25	1.8%	13.88
<b>GRAND TOTAL</b>		<b>125.00</b>	<b>81.8%</b>	<b>25.00</b>	<b>16.4%</b>	<b>2.75</b>	<b>1.8%</b>	<b>152.75</b>
Përqindje		81.8%		16.4%		1.8%		100%

**LIGJ**  
**Nr. 130/2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 129, DATË 11.5.2009 “PËR  
GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. “Emra/mbiemra të papërshtatshëm” janë emrat me karakter fyes, imoral ose racist, qesharakë, të vështirë për t’u thirrur, apo që të çojnë në konfuzion, të përcaktuar si të tillë në udhëzim të ministrit, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Çdo institucion, organ, person juridik apo fizik, privat apo shtetëror, që nuk përfshihet në pikën 2 të këtij neni, mund të kërkojë dhe të marrë të dhënat e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse merr pëlqimin me shkrim nga ana e personit, subjekt i të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e gjendjes civile përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për të cilin ka dhënë pëlqimin me shkrim personi, subjekt i të dhënave.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej subjekteve të treta, sipas pikave 2 dhe 2/1 të këtij neni, sipas procedurës të parashikuar me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon gjendjen civile dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë udhëzim përcaktohen lloji, mënyra e dhënies dhe sasia e informacionit, që mund t’u jepet subjekteve kërkuese, në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre apo pëlqimin me shkrim të dhënë nga personi, subjekt i të dhënave, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

**Neni 3**

Në nenin 25 pika 3, shkronja “b” shfuqizohet.

**Neni 4**

Në nenin 29, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:



“3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokumentesh bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.”.

Neni 5

Neni 30 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 33, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shkëmbimi i të dhënave bëhet nëpërmjet kornizës kombëtare të ndërveprimit, sipas specifikimeve teknike të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, e cila koordinohet zhvillohet dhe administrohet nga Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.”.

Neni 7

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

#### **Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes**

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.”.

Neni 8

Në nenin 56, pikat 4 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 9

Neni 57 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 57

#### **Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit**

1. Mbiemri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
  - a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes;
  - b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji.
2. Emri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
  - a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes, në rastin e birësimit;
  - b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji, brenda 1 viti nga mbushja e moshës madhore, dhe vetëm një herë, si dhe sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 10

Pas nenit 57 shtohen nenet 57/1, 57/2, 57/3, 57/4, 57/5, 57/6, 57/7, 57/8, 57/9 dhe 57/10 me këtë përmbajtje:

“Neni 57/1

**Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar**

1. Me përjashtim të rastit të korigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

2. Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë.

3. Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni.

Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, të përcaktuara si të tilla sipas procedurës së përmendur në pikën 4 të këtij neni.

4. Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror.

Neni 57/2

**Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës**

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) vërtetimin e gjendjes gjyqësore/formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- b) vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale;
- c) vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor;
- ç) kopjen e letërnjoftimit;
- d) certifikatën e lindjes dhe certifikatën e përbërjes familjare;
- dh) vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër;
- e) vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes.

Neni 57/3

**Rastet kur ndalohet ndryshimi i emrit dhe mbiemrit**

Emri dhe mbiemri nuk ndryshohen në rastet kur:

- a) shtetasi është në proces gjyqësor ose nuk ka mbaruar ndjekja penale;
- b) vërtetohet se ndaj shtetasit është marrë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër.





#### Neni 57/4

### Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

1. Kërkesa për ndryshimin e emrit/mbiemrit i paraqitet përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Tarifatat për paraqitjen e kërkesës përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhen nga kërkuesi me depozitimin e kërkesës.

2. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile formon fashikullin e kërkesës me dokumentet përkatëse dhe, pasi ka verifikuar nëse ka shënime të mëparshme në regjistrin e gjendjes civile, brenda 60 ditëve, e përcjell fashikullin pranë prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet zyra e gjendjes civile, së bashku me mendimin e tij lidhur me plotësimin e dokumentacionit dhe verifikimin paraprak të arsyeve të kërkesës së paraqitur.

3. Prefekti, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kërkesës, kryen këto verifikime:

- a) pasjen ose mospasjen e juridiksionit;
- b) hetimin për praninë e shkaqeve që legjitimojnë kërkesën dhe legjitimitimin e kërkuesit, sipas nenit 57 të këtij ligji;
- c) respektimin e procedurave dhe të afateve kohore, brenda të cilave duhej të ishte paraqitur kërkesa;
- ç) vlerësimin e arsyeve të kërkesës;
- d) marrjen e dokumenteve zyrtare, provave të nevojshme apo informacionit të nevojshëm për trajtimin e kërkesës.

Prefekti, kur çmon se janë përmbushur kushtet dhe procedurat, sipas këtij ligji, urdhëron afishimin e shpalljes të kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa, pranë vendbanimit të kërkuesit, si dhe në dy prej gazetave për një periudhë prej 15 ditësh, si dhe/ose në Fletoren Zyrtare. Shpallja duhet t'u njoftohet personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuesit apo të atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar. Forma dhe përmbajtja e shpalljes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile. Tarifatat për afishimin e shpalljes përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhen nga kërkuesi përpara se të bëhet afishimi i shpalljes.

4. Prefekti, kur çmon se kërkesa nuk plotëson dokumentacionin shoqërues apo elementet formale të saj, cakton një afat jo më të shkurtër se 30 ditë për plotësimin e kërkesës, duke njoftuar kërkuesin dhe zyrën e gjendjes civile, ku ai ka vendbanimin. Nëse brenda këtij afati kërkuesi nuk plotëson të metat e kërkesës, prefekti vendos për deklarimin e braktisjes së procedurës dhe arkivimin e kërkesës. Në këtë rast kërkesa nuk evidentohet në shënimet e gjendjes civile.

#### Neni 57/5

### Kundërshtimi i të tretëve

1. Çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

2. Kundërshtimi bëhet me kërkesë me shkrim dhe duhet të depozitohet pranë prefektit ose në zyrën e gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Në këtë rast, kërkesa i përcillet pa vonesë prefektit të qarkut ku bën pjesë zyra e gjendjes civile.

Neni 57/6

### **Vendimi për kërkesën**

1. Me kalimin e afatit të parashikuar për kundërshtimin e të tretëve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së parashikuar, si dhe vlerësimit të kundërshtimeve që mund të jenë paraqitur, prefekti nxjerr mendim të arsyetuar për themelin e kërkesës për ndryshimin, sipas rastit, të emrit apo mbiemrit, duke i propozuar Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesës për ndryshimin e emrave apo të mbiemrave pranimin apo refuzimin e ndryshimit.

Mendimi i prefektit për kërkesën për ndryshimin e emrit apo mbiemrit, së bashku me fashikullin e kërkesës, i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit Kombëtar pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, i cili vendos për kërkesën, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse prefekti vlerëson se ndryshimi i kërkuar ka të bëjë me mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara apo të mirënjohura në juridiksionin e tij, që nuk janë në listën e miratuar me udhëzim, përpara përcjelljes së kërkesës pranë Komisionit Kombëtar, ai ka të drejtë t'i kërkojë mendim këshillit komunal ose atij bashkiak apo institucioneve të tjera publike të specializuara të fushës për marrjen e emrave apo mbiemrave që kërkohen të merren nga kërkuesi. Mendimi i këshillit komunal/bashkiak, apo i institucionit të specializuar, përfshihet në fashikullin që shoqëron kërkesën. Nëse këshilli komunal/bashkiak apo institucioni i specializuar nuk shprehen brenda afatit 90 ditor, ky fakt konsiderohet si mos kundërshtim i heshtur i kërkesës dhe evidentohet në procesverbal nga ana e prefektit.

3. Me qëllim vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave/mbiemrave, pranë ministrisë që mbulon punët e brendshme, krijohet Komisioni Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave. Përbërja dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit miratohen me urdhër të ministrit që mbulon punët e brendshme.

4. Pas përcjelljes së kërkesës dhe fashikullit shoqërues në Komisionin Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, ky i fundit, në përfundim të procedurës administrative për marrjen e të dhënave të nevojshme, shprehet me vendim përfundimtar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit.

5. Vendimi i komisionit, i arsyetuar, i njoftohet kërkuesit dhe personave të interesuar, prefektit, si dhe zyrës së gjendjes civile përkatëse për veprim, sipas rastit, si dhe për mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistër.

Neni 57/7

### **Kërkesa për korrigjimin e emrit dhe mbiemrit**

Çdo person, që ka interes për të korrigjuar emrin/mbiemrin e vet, për shkak të një gabimi të provuar material, të bërë gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, mund të paraqesë kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin.

Neni 57/8

### **Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës për korrigjim material**

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) kopje të aktit të lindjes;
- b) çdo dokument tjetër që provon gabimin.



Neni 57/9

**Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës**

1. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t'ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar.

2. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 57/10

**Efektet e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit të ri**

Pas miratimit të kërkesës së shtetasit, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar.

Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Rregullat dhe procedurat për pasqyrimin e ndryshimit të emrit/mbiemrit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile përcaktohen nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile.”.

Neni 11

Titulli i kreut X ndryshohet si më poshtë:

**“KREU X  
GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE  
E PERSONAVE PA SHTETËSI”**

Neni 12

Në nenin 74 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 15 pika 3, në nenin 19 pikat 1 dhe 2, në nenin 20 pika 1, në nenin 21 pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 52 pikat 3, 5 dhe 7 dënohet me gjobë në masën 3 000 lekë.”.

2. Në pikën 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 18 pikat 2 dhe 3, në nenin 20 pika 2, në nenin 41 pika 6 në nenin 52 pika 4 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.”.

3. Në pikën 1 shkronja “c”, fjalët “në nenin 65 shkronja “dh”” zëvendësohen me fjalët “në nenin 65 shkronja “g””.

Neni 13

Në nenin 76, referenca në nenin “33” hiqet.

Neni 14

Kudo në ligj fjala “kombësi” hiqet.

Neni 15

**Dispozita kalimtare**

Procedura për ndryshimin e emrit/mbiemrit, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në datën e paraqitjes së kërkesës.

Neni 16

**Aktet nënligjore**

Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenet 1 dhe 10 të këtij ligji.

Neni 17

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8148, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**VENDIM**

**Nr. 40/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93, DATË 7.4.2011 “PËR  
MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE  
TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 93, datë 7.4.2011 ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.



II. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 93, datë 7.4.2011 ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

Miraturar në datën 6.5.2013

*Lidhja nr.1*

**STRUKTURA**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**



Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË  
DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

(Struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës janë miratuar sipas vendimit  
të Kuvendit nr. 93, datë 7.4.2011)

<b>Funksioni</b>	<b>Nr. i punonjësve/Kategoria/klasa</b>	
<b>I. Inspektori i Përgjithshëm</b>	1	Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	
<b>II. Sekretari i Përgjithshëm</b>	1	
<b>III. Inspektorë</b>		
Inspektorë	12	
Ndihmësinsektorë	12	
<b>IV. Drejtoria e Kontrollit të Konfliktit të Interesave</b>		
Drejtor	1	
Specialistë	4	III-b
<b>V. Drejtoria e Marrëdhënieve me Institucione dhe Organizata</b>		
Drejtor	1	
<b>V/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse</b>		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	3	III-b
<b>V/2. Sektori i Këshillimit Juridik</b>		
Specialistë	2	III-b
<b>VI. Drejtoria e Financave dhe Administrimit</b>		
Drejtor	1	
<b>VI/1. Sektori i Administrimit të IT</b>		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
<b>VI/2. Sektori i Administrimit të Protokoll-Arkivit</b>		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
<b>VI/3. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit</b>		
Specialist finance	1	IV-a
Specialist buxheti	1	III-b
Magaziniere	1	VI
Shofer	1	IV
Receptionist	1	III
Pastruese	2	I
<b>Gjithsej</b>	<b>53 punonjës</b>	

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 13.5.2013  
Doli nga shtypi më 13.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë